

MODUL TRAJNIMI PËR SHËRBIMET BAZUAR NË PERFORMANCË

MENAXHIMI I MBETJEVE TE NGURTA NË NIVEL VENDOR



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

dldp
decentralisation and local
development programme



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA

**MODUL TRAJNIMI
PËR SHËRBIMET
BAZUAR
NË PERFORMANCË**

MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË NIVEL VENDOR

Ky modul trajnimi është përgatitur nga Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp), me mbështjetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC).

ZHVILLUAR NGA:

Eduart CANI dhe Konalsi GJOKA

Emilie GEX dhe FELIX SCHMIDT

CSD INGENIEURS SA, Lausanne, Switzerland

NDIHMUAR NGA:

Valbona KARAKAÇI, Arben KOPLIKU

Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp), Shqipëri

Copyright © HSI Albania 2017

L. Kongresi Permetit, Rr.Oso Kuka, Nr. 11
Shkodër, Albania
www.dldp.al

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|-----------|
| RRETH KËTIJ MODULI TRAJNIMI | 7 |
| KONTEKSTI I POLITIKAVE | 8 |
| DISPOZITAT RREGULLATORE..... | 10 |
| STRUKTURA E MODULIT | 12 |
| Kapitulli 1: PLANIFIKIMI I BAZUAR NË PERFORMANCË dhe monitorimi | 13 |
| 1.1 Hyrje..... | 13 |
| 1.2 Në lidhje me këtë kapitull dhe çfarë do të mësohet..... | 14 |
| 1.3 Integrimi i PBP në procesin e planifikimit..... | 16 |
| 1.4 Zhvillimi i një procesi planifikimi bazuar në performancë | 18 |
| 1.4.1 <i>Përfaqja e përgjithshme</i> | <i>18</i> |
| 1.4.2 <i>Përcaktimi i përballueshmërisë</i> | <i>22</i> |
| 1.4.3 <i>Hapi 1: Vlerësimi i situatës aktuale.....</i> | <i>23</i> |
| 1.4.4 <i>HAPI 2: Krahasimi i skenarëve të ndryshëm.....</i> | <i>24</i> |
| 1.5.2 <i>HAPI 3: Përcaktimi i një objektivi 5-vjeçar për secilin komponent të shërbimit (bazuar në skenarin e zgjedhur).....</i> | <i>26</i> |
| 1.5 Shpjegimi i indikatorëve të performancës dhe metodat e llogaritjes së tyre | 31 |
| 1.5.1 <i>Indikatorët e cilësisë së shërbimit</i> | <i>33</i> |
| 1.5.2 <i>Indikatorët e qëndrueshmërisë mjedisore</i> | <i>35</i> |
| 1.5.3 <i>Indikatorët e qëndrueshmërisë institucionale, ekonomike dhe financiare</i> | <i>36</i> |
| Kapitulli 2: Monitorimi i shërbimit..... | 38 |
| 2.1 Hyrje..... | 38 |
| 2.1.1 <i>Përse NJQV duhet të realizojë monitorimin e performancës së shërbimit?</i> | <i>38</i> |
| 2.1.2 <i>Si do t'i ndihmojë ky kapitull NjQV-të për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të mbetjeve?.....</i> | <i>39</i> |
| 2.1.3 <i>Hapat kryesor të sistemit të monitorimit.....</i> | <i>39</i> |
| 2.2 Qëllimi dhe objektivat e monitorimit..... | 40 |

| | | |
|---|---|-----------|
| 2.3 | Aktorët e përfshirë në nivelin lokal..... | 41 |
| 2.4 | Zhvillimi i skemës së monitorimit të performancës..... | 42 |
| 2.4.1 | <i>Mbledhja e të dhënave</i> | 42 |
| 2.4.2 | <i>Analizimi i të dhënave</i> | 44 |
| 2.4.3 | <i>Identifikimi i nevojave për të përmirësuar shërbimin</i> | 44 |
| 2.4.4 | <i>Hartimi i masave korrektuese</i> | 46 |
| 2.4.5 | <i>Përdorimi i teknologjisë për supervizimin e shërbimit</i> | 46 |
| 2.5 | Aplikimi i skemës së monitorimit të shërbimit – Shkodra rast studimor | 48 |
| 2.5.1 | <i>Bashkia (Drejtoria e shërbimeve publike)</i> | 51 |
| 2.5.2 | <i>Kryetarët e rajoneve dhe inspektorët.....</i> | 51 |
| 2.5.3 | <i>Supervisorët e shërbimit</i> | 53 |
| 2.5.4 | <i>Supervizori/kontrolluesi në landfilld</i> | 56 |
| 2.5.5 | <i>Kompania që ofron shërbimin (kontraktori)</i> | 57 |
| 2.5.6 | <i>Aplikimi i sanksioneve</i> | 58 |
| 2.6 | Pikat kryesore për t’u mbajtur mend | 62 |
| Kapitulli 3: Sistemi i benchmark-ut | | 63 |
| 3.1. | Hyrje në sistemin e benchmark-ut | 63 |
| 3.1.1 | <i>Përse standardet dhe sistemi i benchmark-ut janë të rëndësishme për NjQV-të?</i> | 64 |
| 3.1.2 | <i>Si do t’i ndihmojë ky kapitull NjQV-të për të përmirësuar praktikat e menaxhimit të mbetjeve?.....</i> | 65 |
| 3.2 | Indikatorët e performances të përdorur nga sistemi i benchmark-ut | 65 |
| 3.3 | Matja dhe vlerësimi i performancës | 68 |
| 3.3.1 | <i>Punë në grup – Ushtrim për matjen e indikatorëve të performancës.....</i> | 69 |
| 3.4 | Aktoret e përfshirë në sistemin e raportimit për menaxhimin e mbetjeve (sistemit të benchmark-ut)..... | 71 |
| 3.4.1 | <i>Ushtrim / Diskutim – Statistikat e mbetjeve të gjeneruara në nivel lokal</i> | 74 |
| Shtojcë- Shembull– Ilogaritja e përbalueshmërisë | | 75 |

RRETH KËTIJ MODULI TRAJNIMI

Ky modul është zhvilluar për të konsoliduar nismat e ndërmarra nga disa projekte gjatë 15 viteve të fundit dhe vizionit të fundit të qeverisë shqiptare, që më së fundi të vërë në veprim dijet e grumbulluara në shërbimin e rishikimit. Manuali është i fokusuar vetëm në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve.

Ky manual ndërtohet mbi eksperiencën e mbledhur dhe kurrikulat e zhvilluara të trajnimeve, manualet dhe udhëzuesit për të rritur kapacitetet e ekspertëve në nivel lokal, të zbatuara nga një program i mundësuar nga Zvicra dldp. Paketa të tilla janë zhvilluar për planifikimin strategjik dhe menaxhimin e financave publike, menaxhimin e mbetjeve, e-gov dhe qasjen në fonde.

Duke marrë parasysh se një nga objektivat kryesore të fazës së tretë të dldp është ancorimi i instrumenteve, bashkëpunimi me Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) shihet si një mundësi e mirë edhe ancorimi i planit mësimor të zhvilluar nga programi, por gjithashtu vendosja e një sistemi certifikimi për punonjësit e shtetit, të rëndësishme për sistemin e tyre të karrierës. Janë zhvilluar modalitetet të trajnimit për çështjet e menaxhimit të mbetjeve me ekspertët nga 61 bashki (trajnim në mbarë vendin). Falë bashkëpunimeve të ngushta me ASPA, janë përcaktuar afatet për shpërndarjen e moduleve të trajnimit dhe afateve kohore përkatëse përgjatë një procesi-1 vjetor, ashtu si dhe metodologjia dhe instrumentet për verifikimin e dijeve në fund të trajnimit (certifikimit). Dldp tashmë ka nisur dy cikle të trajnimeve afatgjata për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe trajnimin për planifikimin strategjik dhe menaxhimin e financave publike.

Kurrikula tashmë është zhvilluar dhe konsiston në 4 module për kurset e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta: 1. Planifikimi i mbetjeve lokale; 2. Minimizimi i mbetjeve dhe landfilli; 3. Përlllogaritja e kostos dhe vendosja e tarifës; dhe, 4. Planifikimi, monitorimi dhe “benchmark-ing” të bazuara në performancë.

Manuali dhe modulet e tij të lidhura me trajnimin do të miratohen nga ASPA dhe dijet do të vlerësohen nga ky institucion, duke marrë dhe një certifikatë kualifikimi. Ndërlidhja me kërkesat për edukim të vazhdueshëm do të koordinohet me ASPA dhe do të mandatohet nga ministritë e linjës për koordinimin e gjenerimit të mbetjeve. Trajnimet kombëtare kanë si qëllim të ndërtojnë një model të edukimit profesional nëpërmjet ASPA, që do të merret edhe me tema të tjera.

KONTEKSTI I POLITIKAVE

Planifikimi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta nënkupton një sërë teknikash dhe mjetesh për të bërë të mundur adresimin e nevojave dhe përshtatjen e qasjeve të drejta për shërbim transparent, i lehtë për t'u kryer dhe i përballueshëm për qytetarët.

Në këtë kontekst dldp ka punuar me ekspertë ndërkombëtarë të qeverisjes vendore në këto 9 vitet e fundit për të zhvilluar mjetet e duhura të planifikimit për të mbështetur bashkitë në shpërndarjen e shërbimeve efikase.

Mjetet kryesore të zhvilluara për sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta janë:

1. Manuali për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor

Ky manual për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve lokale, vjen si një udhëzues praktik për të gjithë NJQV-të që merren me çështjet e menaxhimit të mbetjeve.

Objekti kryesor i këtij manuali është të mundësojë një udhëzim praktik dhe të kuptueshëm për qeverisjen vendore, duke marrë në konsideratë zhvillimin e një plani lokal për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, duke mbuluar hartimin, zbatimin dhe monitorimin e procesit të planit. Përveç kësaj, ky manual mund të shërbejë si një burim për autoritetet lokale që dëshirojnë për të analizuar situatën aktuale, identifikimin dhe vlerësimin e opsioneve, metodologjive dhe skenarëve, përcaktimin e kostove dhe nevojave financiare, rregulloren, ku përcaktohet dhe organizimi në çdo fazë të menaxhimit të mbetjeve, nga gjenerimi i mbetjeve deri në asgjësimin përfundimtar.

Një tjetër objektivi i këtij manuali është të nxjerrë në pah dhe të shpërndajë të mirat e përvojave lokale, projekteve dhe praktikave, të cilat kanë zhvilluar më shumë se një seri të trajnimit, stërvitjeve dhe konsultimit nëpërmjet seancave me NJQV-të, veçanërisht në rajonin e Shkodrës dhe të Lezhës. Praktika të tilla janë përdorur për të ilustruar hapat teknikë dhe udhëheqës të manualit për ta bërë atë sa më të kuptueshëm për përdoruesin dhe për të nxitur nisma të ngjashme në rajone të tjera.

2. Mjeti/Udhëzuesi për llogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve të ngurta (bazuar në programin excel, zhvilluar në 2012 dhe konsoliduar në 2015)

Mjeti/Udhëzuesi është një sistem i kuptueshëm i bazuar në programin excel, i cili kërkon të dhëna minimale nga ana e përdoruesit për të prodhuar kostot e lidhura me objektet, kostot administrative dhe operacionale në një formë të detajuar për NJQV-të. Ky mjet mundëson numrin e saktë të kamionëve dhe kazanët, të nevojshme për grumbullim dhe transportim dhe shpenzimet përkatëse, numri i punimeve në të gjitha segmentet e punës dhe kostot e lidhura me to, shpenzimet për transportin dhe depozitimin dhe shpenzimet e lidhura, shpenzimet administrative dhe të ri-investimit, të zgjëruara për turizmin lidhur me operacionet dhe shpenzimet. Është i lehtë për t'u përdorur, por gjithsesi vetëm njerëzit e trajnuar, të cilët janë në gjendje për të interpretuar rezultatet e dhëna nga modeli, duhet ta përdorin atë. Është i pajisur me një udhëzues i cili ofron njohuri për përdoruesit, për të kuptuar formulat dhe logjikën.

3. Mjeti/Udhëzuesi për llogaritjen e tarifës për mbetjet e ngurta (bazuar në programin excel, zhvilluar dhe konsoliduar në 2015)

Modelimi i tarifës është një model pioner, i cili përkthen parimet e mbrojtjes së mjedisit, përgjegjësinë e prodhuesve të ndotjes si dhe reduktimin e minimizimin e mbetjeve. Mjeti për tarifën është zhvilluar në formatin excel, në një model lehtësisht të kuptueshëm për përdoruesit. Ky kërkon të dhëna të sakta nga NJQV-të, gjithashtu është i lehtë të mirëmbahet dhe të operohet. Ai është në

gjendje të japë një faturë për çdo prodhues në familje, nivel institucioni apo biznesi. Mjeti është i shoqëruar me një udhëzues, i cili mundëson dijen për përdoruesit për logjikën e sistemit dhe qasjes së zgjedhur.

4. Indikatorët “Benchmarking” për dispozitat e shërbimit për mbetjet urbane

Ky dokument paraqet përpjekjet fillestare për të mundësuar hartimin e disa indikatorëve që masin performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe të performancës në drejtim të zbatimit të politikave të menaxhimit të mbetjeve në nivel qendror.

Për qëllim të planifikimit në nivel lokal, ofruesit e shërbimit janë të detyruar të ndjekin hapat e mëposhtëm, duke përdorur burimet e siguruara nga mjetet e listuara më sipër.

Për indikatorët e performancës, vetëm indikatorët e ofruar më sipër do të përdoren në këtë dokument me shpjegimet e duhura që janë dhënë në aneks.

DISPOZITAT RREGULLATORE

Të mësuarit në këtë modul trajnimi janë parashikuar në dy drejtime kryesore ligjore dhe rregullatore: 1. Standardet e larta të ofrimit të shërbimit; dhe, 2. Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësim në vazhdim.

Ofrimi i shërbimeve me standarde të larta janë paraparë në kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Këto standarde duhet të vihen në zbatim nëpërmjet ligjit organik për vetë-qeverisjen vendore, i cili parasheh qartë shërbime të ofruara me bazë performance dhe monitorim të vazhdueshëm.

Këto koncepte janë materializuar në ligjin organik, i cili kërkon për herë të parë shërbime me bazë performance në nivel vendor, me pritshmëri në ndërtimin e sistemit të indikatorëve, kontrollit dhe monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit bazuar në këto indikatorë.

Ligj Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 33,
“Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike” ...

2. Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njësia vendore do të jetë përgjegjëse për:

- a) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare;
- b) hartimin dhe vendosjen e një sistemi indikatorësh, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës;
- c) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.

Neni 41 “Buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm” ...

d) objektivat kryesore të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë indikatorët e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Edukimi dhe kualifikimi në vazhdim është një domosdoshmëri për t’u përballuar me zhvillimet shumë dinamike në këtë sektor. Dimensionet e reja të zhvillimit dhe mekanizmat për përmirësimin e procesit të integritit në BE janë materializuar shumë shpesh në kuadrin rregullator shqiptar. Në këtë aspekt çdo nëpunës civil e specialist në departamentin e ofrimit të shërbimeve do të duhet të forcojë kapacitetet e tij/saj për t’u përballuar me standardet dhe pritjet e një vendi në zhvillim si Shqipëria.

Në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e ofruar nga statusi i nëpunësit civil dhe aktet ligjore dhe nënligjore të lidhura me të, mundësitë për edukim dhe kualifikim në vazhdim mbështeten nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), bazuar në dispozitat e përcaktuara nga VKM rregullatore si më poshtë:

Vendim Nr. 138, datë 12.3.2014 "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë"

KREU IV

TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVILË

1. Nëpunësi civil u nënshtrohet veprimtarive të detyrueshme, të përgjithshme dhe të veçanta të trajnimit në ASPA, në këto raste:

- a) gjatë periudhës së provës;
- b) me urdhër të drejtpërdrejtë të eprorit, kur shihet e nevojshme për formimin e nëpunësit civil, bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë;
- c) për programe trajnimi të përcaktuara nga DAP-i, në përputhje me politikat e përgjithshme të trajnimit, për të paktën 60 (gjashtëdhjetë) orë trajnimi në vit, për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues;
- ç) për programet e formimit profesional për çdo hap të pagës;
- d) për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës.

2. Për trajnimet e parashikuara në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, nëpunësi i nënshtrohet testimit në fund të trajnimit. Trajnimi konsiderohet i ndjekur me sukses nëse merr, të paktën, 50% të pikëve në testim.

3. Procedurat për testimin dhe vlerësimin parashikohen në rregulloren e brendshme të ASPA-së.

4. Nëpunësi civil mund të trajnohet jashtë vendit, në kuadrin e përgjithshëm të programeve të trajnimit, të organizuara nga institucioni në përputhje me programet e përgjithshme të trajnimit, për një periudhë për jo më shumë se një muaj. Në mbarim të këtyre trajnimeve, nëpunësi duhet të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, për jo më pak se tri vjet.

5. Kur nëpunësi refuzon të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, sipas parashikimit të dhënë në pikën 4 të kreut IV të këtij vendimi, ai duhet të dëmshpërblejë institucionin për shpenzimet e trajnimeve.

6. Nëpunësi civil mund të kryejë trajnime në institucione të tjera trajnuese përveç ASPA-së, deri në një muaj, me iniciativën e tij, por për detyrën që ai kryen, me propozimi n e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit.

7. Nëpunësi civil mund të kryejë trajnime nga 1 (një) muaj deri në 2 (dy) vjet, jashtë apo brenda vendit, të ndërmarra me iniciativën e tij, por për detyrën që ai kryen. Gjatë kësaj kohe ai përzulohet nga shërbimi civil.

8. Të gjitha institucionet e administratës publike detyrohen që, për trajnimet e parashikuara në pikat 4, 6 dhe 7 të kreut IV të këtij vendimi, të dërgojnë informacionin pranë ASPA-së dhe Departamentit të Administratës Publike.

STRUKTURA E MODULIT

Ky modul konsiston në tre kapituj. Një përshkrim i shpejtë për çdo kapitull jepet si më poshtë:

Kapitulli 1: Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet koncepteve të performancës dhe përballueshmërisë; Ky kapitull paraqet një guidë sesi të zhvillojmë planifikimin bazuar në konceptet e vetëmjaftueshmërisë dhe përballueshmërisë; Ai na ofron një metodologji sesi të zhvillojmë dhe të masim indikatorët e performancës në mënyrë që të ballafaqojmë rezultatet e procesit të planifikimit me konceptet e vetëmjaftueshmërisë dhe përballueshmërisë. Ai ndihmon hartuesin e planit fillimisht të kuptojë kufizimet e burimeve financiare të ekonomisë locale e më pas të hartojë objektivat dhe treguesit e planit.

Kapitulli 2: Monitorimi i operacioneve, si një mjet për përmirësim të vazhdueshëm; Ky kapitull është i fokusuar në monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve periodike të menaxhimit të mbetjeve, të cilat mund të ofrohen si nga bashkia ashtu edhe nga ndonjë kompani private. Një sistem i mirë për monitorimin e të gjitha operacioneve në menaxhimin e mbetjeve do ta ndihmojë bashkinë të përmirësojë efikasitetin e shërbimit, të planifikojë më mirë pra t'i përdori më mirë burimet e veta. Edhe ky kapitull ofron për auditorin një metodologji sesi të zhvillosh një sistem operacional monitorimi, duke analizuar të gjithë aktorët e sistemit, lidhjet e përgjegjësive të tyre dhe mjetet e përdorura për këtë qëllim, si në rastin kur shërbimi ofrohet nga bashkia, ashtu edhe kur ai është i kontraktuar. Në përfundim të këtij kapitulli përshkruhet një rast studimor nga Bashkia Shkodër ku ky sistem monitorimi është zbatuar.

Kapitulli 3: “Benchmarking” i menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie; Ky kapitull detajon sistemin e Benchmarkut. Ai synon në shtrirjen e përvojës së mbledhur nga dy kapitujt e mëparshëm (si bashkia mund të monitorojë shërbimet që ofron çdo ditë dhe si ajo mund të vlerësojë performancën e saj) në nivel kombëtar. Ky kapitull i prezanton lexuesit një guidë sesi çdo bashki mund të krahasojë aspekte të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve me bashkitë e tjera, përsa kohë që ekziston një varietet i madh në mënyrën e ofrimit të shërbimit, cilësisë dhe kostos së tij.

Audienca e kurrikulës janë personat përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve për bashkitë në Shqipëri. Ky është moduli i katërt dhe i fundit i programit të plotë të propozuar nga *dldp*. Ai duhet të marrë parasysh përmbajtjen e modulit 1, 2 dhe 3 për të shmangur çdo kontradiktë. Në të njëjtën kohë, moduli duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i pavarur nga të tjerët.

KAPITULLI 1: PLANIFIKIMI I BAZUAR NË PERFORMANCË DHE MONITORIMI

1.1 Hyrje

Sipas “Manualit për Planifikimin e Mbetjeve Lokale”, zhvilluar nga dldp, Plani i Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta është konsideruar tërësisht si një proces ciklik i vazhdueshëm dhe përbëhet nga komponentë të tillë si: planifikimi i përgjithshëm, zbatimi dhe rishikimi i planit. Plani duhet të rishikohet të paktën në intervale 5-vjeçare. Megjithatë, në raste të zhvillimeve të rëndësishme, mund të konsiderohet rishikim më i shpejtë i planit. Rishikimi përfshin ri-vlerësimin e objektivave dhe masave, duke ndjekur të gjithë ciklin e planifikimit. Proçesi i planifikimit të përgjithshëm mund të ndahet në këto faza: mobilizimi i proçesit të planifikimit dhe vlerësimi i situatës aktuale (parimet bazë duke përfshirë auditimet, sondazhet publike, etj.), planifikimi strategjik dhe planifikimi i bazuar në fakte (në afate të shkurtra dhe të mesme), procesi i konsultimit, zbatimit, monitorimit dhe rishikim i planit.

Planifikimi është një kërkesë ligjore dhe, në të njëjtën kohë, një domosdoshmëri për administratën vendore në ushtrimin e funksionit të tyre në menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor. Objektivat e tij duhet të përkthejnë objektivat rajonale e kombëtare dhe objektivat e vendosura nga planet përkatëse (PKMM dhe PRMM). Në realitetin shqiptar objektiva të tilla ndjekin direktivat e BE-së dhe ambiciet e vendit për të arritur standartet e BE-së që janë më të mirat për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Planifikimi gjithashtu ndihmon bashkinë të organizojë burimet e saj në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të popullsisë lidhur me shërbimet bazike.

Megjithatë, objektivat dhe qëllimet e një plani janë të kufizuara për individët dhe veçanërisht për kapacitetet financiare në një njësi vendore. Çdo qëllim ka koston e tij financiare, e cila duhet të financohet në nivel lokal. Plani kërkon përpjekjet dhe mbështetjen e qytetarëve dhe sektorit të biznesit për të mbështetur këto ambicie, duke marrë në konsideratë që shërbimi duhet të mbulohet plotësisht nga financat lokale.

Në lidhje me këtë plani duhet të jetë shumë realist, i hartuar dhe i përshtatur në realitetin lokal, dhe i pranuar nga qytetarët e Njësisë Vendore. Për këtë një vlerësim bazik gjithëpërfshirës kërkohet për të kuptuar kapacitetet financiare dhe prirjet ekonomike lokale dhe të jetë në gjendje të planifikojë një të ardhme realiste.

Këtu futen në diskutim konceptet e vetë-mjaftueshmërisë dhe përballueshmërisë (referenca të ligjit organik). Sipas konceptit të **vetë-mjaftueshmërisë**, një bashki duhet të ketë kapacitete financiare, logjistike e njerëzore, për të mundur shërbim për të gjithë territorin dhe bazuar në kërkesat ligjore. Kjo do të thotë që një bashki është në gjendje të ketë një rrjet të mirë rrugor, kamionë modernë për grumbullimin e mbetjeve, kazanë në të gjithë territorin dhe kazanë për diferencimin e mbetjeve, objekte të duhura për trajtimin e mbetjeve (landfill dhe/ose incinerator), sisteme ripërdorimi dhe riciklimi dhe një departament të krijuar për shërbimet e mbetjeve, të gjitha të financuara vetëm nga bashkia.

Sipas konceptit të **përballueshmërisë**, një bashki duhet të mundësojë një shërbim, i cili mund të financohet nga të ardhurat lokale dhe qytetarët të jenë në gjendje të paguajnë shërbimin nëpërmjet tarifave. Prandaj, sistemi duhet të jetë jo më pak se ajo që kërkon kuadri ligjor dhe jo më shumë se ajo çfarë mund të përballojnë qytetarët. Dispozita të tilla mund të aplikohen pavarësisht profilit

ekonomik të bashkisë, pozitës së saj gjeografike dhe kapaciteteve të saj për të zgjëruar edhe më tej ekonominë e tyre.

Në këtë moment lindin shumë pyetje: Cilat janë standardet që një bashki duhet të ndjekë dhe të zbatojë? Çfarë ndodh nëse bashkia nuk ka kapacitetet financiare për të përballuar këto standarde? Si bashkia mund të bëjë më të mirë me ato kapacitete financiare që ka? Si të merret i njëjti shërbim në të gjithë territorin kur mungon aksesimi në infrastrukturë? Si të përballlet me situatat kur sigurimi i shërbimeve për zonat e largëta është shumë i kushtueshëm? Është më mirë për të mundësuar një shërbim të pranuar, të përballueshëm dhe miqësor me mjedisin apo t'u përmbahemi në mënyrë strikte dispozitave ligjore? A është i mundur financimi i dispozitave ligjore nëpërmjet mbledhjes së tarifave? Nqs jo, cilat standarde minimale të cilësisë së shërbimit duhet të përmbushen? Cilat janë mjetet alternative financiare?

Ku kapitull mundëson një udhëzim se si të zhvillohet një proces planifikimi i bazuar në synimet e vetë-mjaftueshmërisë e të përballueshmërisë dhe se si të vendosen e maten indikatorët e performancës.

Ai ndihmon procesin e planifikimit, duke ndërtuar në shifra reale (analizë e gjendjes aktuale) të cilat janë matuar në bazë të një sere indikatorëve të përzgjedhur për realitetin e bashkive në Shqipëri. Më pas ai mundëson një metodologji se si të projektohet shërbimi bazuar në tri qasje të ndryshme, duke përdorur indikatorët për t'u përballur me rezultatet me konceptet e vetë-mjaftueshmërisë dhe përballueshmërisë. Ndihmon zhvilluesin e planit të kuptojë kufijnjtë e zhvillimit ekonomik lokal dhe kapacitetet financiare në vendosjen e objektivave dhe indikatorëve të planit.

1.2 Në lidhje me këtë kapitull dhe çfarë do të mësohet

Një planifikimi i bazuar në performancë (PBP) është bazuar në një grup të qartë të indikatorëve të pasqyruar në objektivat SMART që synojnë efektshmërinë dhe efikasitetin e dispozitave për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel bashkie. Indikatorët e performancës lejojnë një vlerësim të situatës së vëzhguar, matjen e tendencave, duke siguruar rezultate dhe duke ndihmuar në identifikimin e mjeteve për të arritur këto objektiva. PBP mundëson që sistemi të fokusohet në rezultatet e dëshiruara dhe të kërkua të performancës kur shoqërohen me synimet përkatëse.

Indikatorët e përdorur për PBP mund të jenë cilësorë, sasiorë, absolutë ose relativë dhe ata duhet të mbështeten nga mbledhja dhe analizimi sistematik i të dhënave. Këto të dhëna mund të merren nga burime të tilla si pyetësorë/anketa, raporte të vëzhgimit në terren, raporte teknike, sistemet e monitorimit të funksionimit të performancës, aktivitetet e inspeksionit, dhe më në përgjithësi, të dhënat e zonave si të dhëna ekonomike, sociale dhe organizative. Një PBP ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të shërbimit dhe si pasojë cilësisë së mjedisit dhe cilësisë së jetës për qytetarët dhe të bëjë të mundur që bashkia të jetë më tërheqëse për vizitorët. PBP vendos objektiva të përballueshme për rezultatet e dëshiruara (objektivat) dhe matjen e performancës bazuar në to. Duke u bazuar tek indikatorët, bëhet një mjet i fortë komunikimi me popullsinë lokale.

Ky kapitull ofron njohuri dhe udhëzime se si të shoqërohet procesi i planifikimit për menaxhimin e mbetjeve me indikatorët e performancës për një planifikim më eficient dhe të qëndrueshëm. Përdoruesi do të udhëzohet mbi hapat kryesorë të procesit të planifikimit dhe elementëve kryesorë të planifikimit me performancë, e cila mund të përdoret në secilin prej hapave.

Një grup indikatorësh të performancës janë zhvilluar dhe janë dhënë në këtë kapitull të manualit. Këto indikatorë janë përzgjedhur bazuar në realitetin e bashkive në Shqipëri, kapaciteteve të tyre për

të integruar këta indikatorë në situatën ku nuk ka një sistem të zhvilluar që ndihmon procesin, kapacitete të tyre për grumbullimin, për analizimin dhe përdorimin e indikatorëve.

Për këtë arsye, indikatorët e performancës janë përdorur si në planifikim dhe në monitorimin vjetor të ofrimit të shërbimit, ku bashkia krahason rezultatet e saj me ato të një viti të mëparshëm. Të njëjtët indikatorë mund të përdoren gjithashtu në sistemin e “benchmarkut”, ku bashkia krahason rezultatet e saja me ato të bashkive të tjera, i cili prezantohet në kapitullin e tretë të këtij manuali.

Indikatorët e prezantuar në këtë manual do të përdoren në planifikim sapo të zhvillohet plani dhe pritet të mbështesin zhvilluesin e planit për një grup objektivash afatgjata, ndërkohë përdorimi i këtyre indikatorëve në një informacion më të detajuar bëhet për të matur zbatimin çdo vit dhe situatës aktuale për zhvilluesit e politikave dhe komunitetin në sistemin benchmarking.

Qëllimi i sistemit të performancës së bazuar mbi planifikimin dhe monitorimin është që të krahasojë vit pas viti evolimin e performancës së matur nga indikatorët sikurse dhe të krahasojë këtë zhvillim me koston e shërbimit

Objektivat kryesore të këtij kapitulli janë:

- Të mësohet se si të vendosen dhe maten indikatorët;
- Të kuptohet procesi i planifikimit bazuar në performancë në nivelin vendor;
- Të zhvillohen njohuri se si të vendosen synimet dhe objektivat SMART për një plan eficient dhe të përballueshëm.

Krijimi i strukturave për një PBP

Në mënyrë që të zbatohet një PBP, bashkia duhet të krijojë një njësi për zhvillimin dhe monitorimin e indikatorëve të performancës dhe ofrimin e shërbimit, ashtu siç parashikohet nga ligji organik, Nr.139/2015, “Për qeverisjen vendore”, neni 33 “Instrumentet për menaxhimin e shërbimeve publike”.

Specialistët e caktuar brenda njësisë duhet të marrin trajnimin paraprak të nevojshëm dhe të vazhdueshëm se si:

- Të kryhet PBP;
- Të grumbullohen të dhënat;
- Të kryhet vazhdimisht zhvillimi i raporteve dhe raportimi tek vendimmarrësit;
- Të rishikohen objektivat dhe synimet dhe plani për periudhën e ardhshme të planifikimit;
- Të kryhet koordinimi me strukturat në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në risitë dhe përmirësimet e shërbimit.

1.3 Integrimi i PBP në procesin e planifikimit

Sipas Manualit të Planifikimit për Menaxhimin e Mbetjeve Lokale të zhvilluar nga dldp, plani i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në tërësinë e tij është një proces i vazhdueshëm ciklik, dhe përbëhet nga komponentë të tillë si: planifikimi i përgjithshëm, zbatimi dhe rishikimi i planit.




Figura1: Cikli i planifikimit të menaxhimit të mbetjeve

Plani duhet të rishikohet minimalisht në intervale 5-vjeçare; por në rast të zhvillime të rëndësishme duhet të parashikohet rishikimi i planit. Rishikimi përfshin vlerësimin e objektivave dhe masave, duke ndjekur të gjithë ciklin e planifikimit.

Procesi i përgjithshëm i planifikimit mund të ndahet në këto faza:

- Mobilizimi i procesit të planifikimit dhe vlerësimi i situatës aktuale (analizë e gjendjes duke përfshirë auditimet, sondazhet publike, etj.);
- Planifikimi strategjik dhe planifikimi i bazuar në fakte (në afate të shkurtëra dhe të mesme), vendosja e objektivave;
- Vlerësimi i burimeve të nevojshme për zbatimin e planit, llogaritja e kostos;
- Procesi i konsultimit, vlerësimi i përballueshmërisë;
- Zbatimi, monitorimi dhe plani i rishikimit.




Figura2: Skema e procesit të Planifikimit për Menaxhimin e Mbetjeve (Burimi: dldp: “Manuali: Planifikimi lokal i menaxhimit të mbetjeve, 2012)

Aspektet kryesore kritike në zhvillimin e një plani janë analiza e të dhënave bazë dhe vendosjes së objektivave. Në zhvillimin e një analize të gjëndjes, është e nevojshme vendosja e një seti indikatorësh të cilat përkthehen më pas në objektiva dhe synime me masat përkatëse. Është me shumë rëndësi që këta indikatorë të zhvillohen si duhet përpara fillimit të procesit për grumbullimin e të dhënave.

Ky proces më vonë do të mbështesë zhvillimin e objektivave SMART me synime të qarta dhe të arritshme, të cilat udhëzojnë procesin e planifikimit për të zhvilluar qasjet e drejta që çojnë në masat e arritshme, të bazuara në kapacitetet reale, bazuar në rezultatet e prekshme, duke adresuar kuadrin ligjor dhe rregullator rajonal dhe kombëtar dhe më e rëndësishmja të jenë të përballeshme financiarisht.

1.4 Zhvillimi i një procesi planifikimi bazuar në performancë

1.4.1 Përqasja e përgjithshme

Këtu jepet një metodologji e detajuar se si të zhvillohet secili hap i planifikimit të bazuar në performancë, duke përdorur indikatorët e saj, të cilët shpjegohen nga tabela 1.

Procesi i hartimit të indikatorëve, për vlerësimin e aspekteve të shërbimit të MMN, rezulton si një sintezë mes qëllimit të vëzhgimit që duam të realizojmë si dhe të të dhënave që janë të disponueshme. Kështu lista e gjatë e indikatorëve të dëshirueshëm, reduktohet në një listë më të përmbledhur indikatorësh, të cilët praktikisht ndoshta është më e mundur për t'i matur dhe për t'i përdorur. Diagrama e mëposhtme përmbledh konceptin e hartimit të indikatorëve:




Figura3 Hartimi i indikatorëve të performancës

Një hap tjetër i rëndësishëm në hartimin e indikatorëve të performancës është procesi i konsultimit me të gjitha grupet e interesit për t'u siguruar që indikatorët janë përkufizuar mirë, janë të kuptueshëm dhe të pranueshëm nga të gjithë, lehtësisht të matshëm (duke u mbështetur mbi të dhënat që ekzistojnë) dhe të raportueshëm.

Indikatorët e performancës mund të jenë sasiorë dhe cilësorë. Ashtu sikurse përcaktohet edhe nga termi, indikatorët sasiorë përcaktojnë sasinë. Sasia mund të prezantohet me një numër, përqindje ose raport. Indikatorët sasiorë janë të përdorur gjërësisht në monitorimin e shërbimit, pasi ato japin një matje të qartë të shërbimit e shprehur në numra, të cilët më vonë mund të jenë lehtësisht të krahasueshëm. Kjo i krijon mundësinë çdo eksperti në NjQV të krahasojë performancën e shërbimit të arritur në momente kohore të ndryshme.





Shpesh herë indikatorët cilësorë janë më të preferueshëm për t'u përdorur në matjen e performancës së shërbimit pasi ata nuk kanë nevojë për ndjenja apo gjykim për të përcaktuar sasinë e tyre. E vetmja gjë që duhet janë metodat mekanike, të cilat pritet që në mënyrë teorike të japin të njëjtin rezultat pa marrë në konsideratë faktin se kush i përdor ato.

Indikatorët kualitativ, ashtu siç edhe emërohen nuk tregojnë matje numerike. Për më tepër ata përshkruajnë gjendjen e një shërbimi më tepër në terma cilësorë. Për shumë ekspertë, indikatorët kualitativë nuk paraqiten si shumë tërheqës. Por, nga ana tjetër, është e paqartë që aspekte të ndryshme të shërbimit maten më mirë nga indikatorët cilësorë sesa ata sasiorë. Në përgjithësi indikatorët cilësorë përdoren për të plotësuar më mirë indikatorët cilësorë dhe për t'u dhënë atyre një kuptim më tepër sesa thjesht një përqindje numerike. Për shembull, në qoftë se shkalla e mbulimit me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në një NjQV është 95%, kjo nuk do të thotë se ky shërbim ka domosdoshmërisht edhe cilësinë më të mirë të shërbimit të ofruar në atë rajon ku ndodhet NjQV.

Indikatorët e performancës janë grupuar në 4 kategori të përbërë nga disa indikatorë specifikë. Kategoritë janë: 1. Cilësia e shërbimit; 2. Qëndrueshmëria mjedisore; 3. Qëndrueshmëria ekonomike & financiare dhe aspektet institucionale dhe 4. Kosto.

Arritje janë shkallëzuar në tre nivele (e ulët, mesatare dhe e lartë) dhe janë përfaqësuar nga ngjyrat përkatëse: e kuqe e hapur, e verdhë e hapur dhe e gjelbërt e hapur. Niveli i arritjeve është konsideruar drejt arritjeve të pritshme të çdo indikatorit të zgjedhur për skenarin bazë, ndërsa për skenarët që do të zhvillohen 5 vitet e ardhshme, niveli i tyre është vendosur bazuar në arritjen e objektivit të dhënë me infrastrukturën e dhënë dhe kapacitetin financiar.

Tabela 1: Indikatorët e përzgjedhur të performancës të dhënë për skenarin bazë

| Indikatorët | | Klasifikimi i koduar me ngjyra | | | Saktësia e të dhënave |
|---|--|---|--|---|---|
| | | I ulët | I mesëm | I lartë | |
| | |  |  |  |  |
| Cilësia e Shërbimit | C1 Zona e mbuluar me shërbim | | | | |
| | C1.1 Mbulimi me shërbim në zonat urbane dhe peri-urban | 0 – 40 % | 41 – 80% | 81 – 100% | |
| | C1.2 Mbulimi me shërbim në zonat e largëta/izoluara | 0 – 30 % | 31 – 50% | 51 – 100% | |
| | C2 Pastërtia e qytetit | 0 – 32 % | 33 - 66% | > 66% | |
| | C3 Perceptimi publik:shkalla e kënaqshmërisë publike me shërbimin | 0 – 50% | 51% - 80% | 81% - 100% | |
| Qëndrueshmëria mjedisore | D1 Ripërdorimi: Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në zonat urbane | 0 – 5% | 5 – 20% | >20% | |
| | D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfillet inxhinierikë dhe zonat e miratuara dhe kontrolluara për depozitim | 0 – 30% | 31 – 70% | 71 – 100% | |
| Qëndrueshmëria e institucioneve ekon.&financ. | E1 Mbulimi i koston: Tarifa mbulon koston | 0 – 35% | 36 – 70% | 71 – 100% | |
| | E2 Si qytetarët mund të kontribuojnë në financimin e shërbimit: shkalla e mbledhjes së tarifave | 0 – 40% | 41 – 75% | 75 – 100% | |
| | E3 Transparenca e sistemit të faturimit | I ulët | I mesëm | I lartë | |
| Kosto e shërbimit | |Lek/tLek /banorë / vit | | | |

Procesi i mirëmbajtjes së të dhënave dhe i raportimit të tyre është një kulturë e munguar në NjQV dhe si e tillë paraqet një sërë vështirësisë, të cilat mund ta impaktojnë procesin e monitorimit në të ardhmen. Është e pritshme që besueshmëria e të dhënave apo kualiteti i tyre ndikon në matjen e indikatorëve, e për rrjedhojë do të ndikojë edhe në përcaktimin e nivelit të dëshiruar të cilësisë së shërbimit. Ndaj kjo metodologji propozon një klasifikim të të dhënave si më poshtë:

- të dhëna me nivel të ulët besimi;
- të dhëna me nivel të mesëm besimi;
- të dhëna me nivel të lartë besimi (të dëshiruara).

Për të mbështetur qasjen me anë këtij modeli planifikimi është propozuar procesi i planifikimit me bazë performance si më poshtë:

Tabela 2: Qasja e planifikimit me bazë performancën

| Nr. Hapit | Titulli i Hapit | Përshkrimi |
|------------------|--|---|
| Hapi 1 | Me ndihmën e indikatorëve të bëhet analiza e situatës aktuale (studimi bazë) | <i>Indikatorët e nevojshëm për planifikimin e bazuar në performancë janë dhënë në tabelën e mësipërme dhe do të shërbejnë si një skenar bazë për vendosjen e objektivave në skenarin e përzgjedhur.</i> |
| Hapi 2 | Analiza e kapacitetit ekonomik dhe financiar të Bashkisë dhe analiza e tendencies së sjelljes së qytetarëve në lidhje me pagesën e tarifës | <i>Kjo nuk është domosdoshmërisht e bazuar tek indikatorët, por më tepër në tendencat dhe kapacitetet për të përballuar një masë të caktuar. Megjithatë, disa informata duhet të mblidhen mbështetur në indikatorët financiarë dhe më pas të prezantohen në manual.</i> |
| Hapi 3 | Përcaktimi i objektivave dhe synimeve bazuar në skenarë të ndryshëm | <i>Të përdoren indikatorë të performancës së skenarit bazë, që lidhen me situatën aktuale dhe zhvillojnë 2-3 skenarë të objektivave dhe synimeve, të cilat krahasohen me skenarin bazë, duke patur parasysh sjelljet dhe kapacitetet financiare për 5 vitet e ardhshme.</i> |
| Hapi 4 | Analiza financiare e secilit skenar | <i>Të zhvillohet një analizë e hollësishme financiare për secilin prej skenarëve të propozuar duke u fokusuar në dijet e dhëna nga manuali për planifikimin MMN, e cila konsideron zhvillimin e infrastrukturës, shpenzimet operative, amortizimin, shpenzimet administrative etj. Shpenzimet janë analizuar më vonë në bazë të përballueshmërisë së qytetarëve për të paguar për tarifa në krahasim me nivelin aktual të tarifave dhe shkallën e arkëtimit dhe kapacitetin maksimal të zbatimit.</i> |
| Hapi 5 | Rënia dakort për skenarin më të vetë-mjaftueshëm dhe të | <i>Bazuar në analizat e zhvilluara të akomodohen në maksimum konceptet e vetë-mjaftueshmërisë dhe përballueshmërisë dhe një përputhje maksimale me</i> |

| | | |
|---------------|---|--|
| | përballueshëm dhe më pas zhvillimin e tij | kuadrin ligjor dhe rregullator. |
| Hapi 6 | Analiza e hendekut financiar drejt standarteve ligjore (nëse ka) dhe detyrimet | Duke marrë parasysh skenarin e zgjedhur, të analizohet boshllëku financiar për të mbuluar kostot dhe të dokumentohet në mënyrë të rregullt. |
| Hapi 7 | Promovimi i hendekut dhe të bëhen përpjekje për mbështetje me mjete të tjera financiare | Hendeku duhet të përcaktohet mjaft mirë në plan dhe mënyrat për ta plotësuar atë duhet të përcaktohen në plan. Do të jetë një objektivi tjetër për t'u arritur dhe mund të adresohet duke zhvilluar projekt propozime e duke përdorur fondet e ndihmës kombëtare dhe të huaja. Këshilli bashkiak mund të përshtasë planin duke marrë në konsideratë këtë hendek, kështu që administrata lokale mund të informojë zyrtarisht autoritetet rajonale dhe kombëtare për nevojat për mbështetje nga kuadri ligjor dhe rregullator në menaxhimin e mbetjeve. |

Ky proces në mënyrë skematike është paraqitur më poshtë:




Figure 4: Skema e planifikimit bazuar në performancë

1.4.2 Përcaktimi i përballueshmërisë

Sipas ligjit Nr. 139/2015, "Për qeverisjen vendore", "shërbimet publike" përcaktohen si shërbime për interesin e përgjithshëm publik, të cilat u mundësohen komunitetit nga bashkia, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, bazuar në standartet minimale kombëtare, të përcaktuara nga ligji dhe akte të tjera normative. Më pas, në nenin 32, ofrimi i shërbimeve kërkon përdorimin e instrumenteve për të llogaritur përballueshmërinë e shërbimit nga vetë bashkia.

Duke marrë në konsideratë që termi "i përballueshëm" nuk është përcaktuar si duhet për shërbimin publik, por vetë kuptimi i fjalës mund të ndihmojë. **Prandaj, një shërbim i përballueshëm mund të konsiderohet një shërbim që shumica e popullsisë është në gjendje ta paguajnë për të.**

Pavarësisht se shërbimi do të mbulohet plotësisht nga tarifa apo pjesërisht nga financat e bashkisë, burimet financiare janë gjithmonë të kufizuara pasi si gjeneruesit e mbetjeve dhe bashkia kanë shumë shërbime të tjera për të mbuluar, të cilat kanë përparësitë e tyre.

Prandaj, llogaritja për çmimet e përballueshme për shërbimin kërkon një ushtrim teknik dhe vendim politik. Në mënyrë që të lehtësohet vendosja e këtij niveli, bashkia duhet të marrë në konsideratë hapat e mëposhtëm:

1. Përcaktimi i kapacitetit ekonomik dhe financiar:
 - a. Si është zhvillimi ekonomik duke kuptuar shkallën e punësimit /norma e papunësisë, të ardhurat dhe standartet minimale të jetesës për familjet;
 - b. Kapaciteti financiar i bashkisë, buxheti i saj vjetor (tendenca 5 vjet).
2. Përcaktimi i nivelit maksimal të shpenzimeve për shërbimin:
 - a. Përcaktimi i shkallës së përqindjes së buxhetit që shkon për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në lidhje me gjithë shërbimet që bashkia duhet të ofrojë gjatë vitit;
 - b. Përcaktimi i përqindjes së shpenzimeve për menaxhimin e mbetjeve për një familje mesatare që mund të paguajë në vit.
3. Llogariturja e kostove për shërbimin:
 - a. Llogariturja e kostos për shërbimin e zgjedhur në skenarë të ndryshëm, si do të paraqiten më poshtë;
 - b. Llogaritë e tarifave bazuar në skenarin e përzgjedhur të shërbimit.
4. Vendosja e nivelit të përballueshëm:
 - a. Krahasimi i kostos së llogaritur me nivelin e caktuar të shpenzimeve (pika2) nga buxheti i bashkisë dhe mbledhja e tarifës;
 - b. Vendosja e skenarit të përballueshëm.

1.4.3 Hapi 1: Vlerësimi i situatës aktuale

1. Sigurimi i informacioneve të përgjithshme (shiko manualin e planifikimit të menaxhimit të mbetjeve lokale), duke përfshirë:

- 1.1. Popullsinë, vendbanimet, zonat e shërbimit, gjenerimi i mbetjeve, gjeografia, infrastruktura e rrugëve, ekonomia, konsumi, sektori i biznesit, institucionet, gjeneruesit e tjerë të mbetjeve, tipologjia e mbetjeve të gjeneruara (urbane, minerare, të rrezikshme, etj.);
- 1.2. Infrastruktura e shërbimit aktual të siguruar (tipet e kamionëve dhe koshave, zonat e grumbullimit dhe objektet e tjera);
- 1.3. Ofrimi i shërbimeve (publike/private), frekuenca e grumbullimit;
- 1.4. Personeli (shërbimi i mbetjeve dhe pastrimit);
- 1.5. Statusi i zonave për depozitimin e mbetjeve dhe operacionet;
- 1.6. Njësitë e riciklimit nëse ka zyrtare ose operatorë të tjerë si psh mbledhësit e mbetjeve.

2. Sigurimi i informacionit financiar duke përfshirë aspektet e:

- 2.1. Buxhetit total të bashkisë;
- 2.2. Buxhetit total të bashkisë lidhur me shërbimet për menaxhimin e mbetjeve të ngurta;
- 2.3. Kosto/banorë;
- 2.4. Tipologjisë së tarifave;
- 2.5. Kapacitetit të rikuperimit të kostos (tarifa mbledhur) në përqindje;
- 2.6. Tarifës së paguar (ekv. banorë./vit).

3. Vlerësimi i performancës aktuale nëpërmjet indikatorëve (tabela e mëposhtme)

Tabela3: Indikatorët për vlerësimin e gjendjes aktuale (Niveli bazë)

| | | | Aktualisht |
|---------------------------------|---------------------------------------|--|------------|
| Cilësia e shërbimit | C1 | Zonat e mbuluara me shërbim | |
| | | C1.1 Mbulimi me shërbim në zonat urbane dhe peri-urban | 60% |
| | | C1.2 Mbulimi me shërbim në zonat e largëta/të izoluara | 20% |
| | C2 | Pastërtia e qytetit | 50% |
| | C3 | Perceptimi i publikur: Shkalla e kënaqësisë | 30% |
| Qëndrueshmëria mjedisore | D1 | Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve | E panjohur |
| | D2 | Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfillet inxhinierikë e zonat e miratuara dhe kontrolluara për depozitim | 30% |
| Qëndrueshmëria Financ&Instituc. | E1 | Mbulimi i kostos: Tarifa mbulon koston | 30% |
| | E2 | Si qytetar mund të kontribuoj në financimin e shërbimit: shkalla e mbledhjes së tarifave | 50% |
| | E3 | Transparenca e sistemit të faturimit | E ulët |
| Kostoe shërbimit | Lek / t..... Lek / banorë / vit | | |

Procesi i planifikimit do të synojë hartimin e shërbimit me qëllim rritjen e këtyre indikatorëve të performancës dhe të reflektojë atë në kosto. Rritja e C1, D1, D2 ose E3 ka një kosto. Objektivi për bashkinë është të vendosë objektiva, të cilat janë të përballueshme për gjendjen e saj.

1.4.4 HAPI 2: Krahasimi i skenarëve të ndryshëm

Në mënyrë që të sigurohet alternativa më e mirë për ofrimin e shërbimit, i cili garanton në të njëjtën kohë mbulim të plotë të zonës (duke i shërbyer të gjithë qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve), mbrojtje të mjedisit, përputhshmëri me kuadrin ligjor, përballueshmëri dhe vetë-mjaftueshmëri, duhet të vlerësohen skenarë të ndryshëm.

Kuadri ligjor dhe rregullator shqiptar në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta është shumë bashkëkohor, duke vendosur nivele të larta standardesh, të cilat janë në përputhje me ato të BE-së. Prandaj, këto kushte të vendosura nga ligji duhet të analizohen në përputhje me konceptet e parashikuara nga ligji themelor i vetëqeverisjes, i cili merr në konsideratë përballueshmërinë dhe vetë-mjaftueshmërinë në dispozitat e shërbimit.

Më poshtë janë prezantuar dy skenarë tipikë dhe indikatorët që duhet të përdoren për vlerësimin. Skenarë të tjerë mund të ndërtohen bazuar në variablat e ofruara. Secili nga variablat ka një ndikim në aspektet financiare të shërbimit, dhe duhet të vlerësohet dhe përlogaritet (psh dërgimi i mbetjeve në zonën e landfillit rajonal ose të venddepozitimit vendor përbën një ndryshim të rëndësishëm). Metodologjia propozon të vendoset dhe llogaritet një skenar fiktiv dhe një të avancuar, ku përmbushen kërkesat ligjore, në mënyrë që të shfaqet hendeku midis këtij skenari dhe skenarit të zgjedhur të propozuar në planin e Bashkisë.

Përcaktimi i objektivave të përballueshme

Skenari i zgjedhur do të ndërtohet nga:

1. Vendosja e objektivave (mbulimin e shërbimit, frekuencën e grumbullimit, përdorimin, riciklimi,..);
2. Analizimi i opsioneve teknike për të arritur objektivat (dizenjimi i shërbimit);
3. Përlogaritja e këtyre opsioneve (nëpërmjet modelit të koston) dhe përcaktimi i një buxheti për shërbimin;
4. Llogaritja e tarifave që duhen vendosur për të mbuluar këto kosto.

Plani duhet të marrë parasysh shërbimet e përballueshme, që nënkupton së kostoja duhet të mbulohet nga tarifat. Është i nevojshëm angazhimi politik për të miratuar rritjen e tarifave. Duhet të vendoset një ekuilibër, duke patur parasysh në njërën anë dëshirat dhe detyrimin ligjor për rritjen e shërbimit dhe, në anën tjetër, kapacitetin financiar të bashkisë.

Kapaciteti financiar varet nga angazhimi politik për të rritur tarifat dhe nga kapaciteti i popullsisë dhe gatishmëria e tyre për të paguar për shërbimin. Kjo më vonë është e lidhur ngushtë me cilësinë e shërbimit të ofruar. Rekomandohet që bashkia fillimisht të garantojë një shërbim bazë, por të besueshëm për qytetarët. Kjo do të përmirësojë pastërtinë e përgjithshme dhe gatishmërinë e popullsisë për të paguar për këtë shërbim. Pasi kjo është arritur, mund të merren parasysh shërbime shtesë.




Figura 5: Hapat për përcaktimin e objektive

Skenarët krahasimor

Ky kapitull jep dy raste si shembuj të vendosjes së objektive.

Skenari 1: 100% mbulim i shërbimit të grumbullimit

Në këtë skenar, përfshihen kriteret e mëposhtme:

- Shërbimi i grumbullimit i ofrohet të gjithë qytetarëve (100% mbulim);
- Nuk ka ndarje të mbetjeve;
- Dërgimi i mbetjeve në venddepozitim;
- Bashkia paguan për ofrimin e shërbimit nga pala e tretë, nëse ka;
- Qytetarët paguajnë tarifën si zakonisht (pra jo plotësisht).

Skenari 2: Sipas kërkesave ligjore (sistemi i 3 koshave + landfill)

Në këtë skenar, përfshihen kriteret e mëposhtme:

- Shërbimi i grumbullimit u ofrohet të gjithë qytetarëve (100% mbulim);
- Sistemi i 3 koshave i ofrohet të gjithë qytetarëve (100% mbulim);
- Mbetjet dërgohen në venddepozitim të kontrolluar ose landfill dhe bëhet pagesë e plotë për operatorin;
- Bashkia paguan plotësisht për shërbimin;
- Tarifa mbulon plotësisht koston.

Çdo bashki duhet të llogarisë kostot e të dy skenarëve, ose të skenarëve të tjerë që mund të diskutohen, në mënyrë që të llogarisë mjetet financiare të nevojshme për të mbuluar këtë kosto si dhe të përcaktojë nëse kjo është e përballueshme apo jo.

Pasi janë krijuar skenarët:

- a) **Përdorni metodologjinë për planifikimin dhe udhëzuesit për llogaritjen e kostos për të bërë përshkrimin teknik:**
- Zona e shërbimit (popullsia, mbetjet e gjeneruara, ditët e shërbimit);
 - Infrastruktura (koshat e grumbullimit dhe kamionët për transport);
 - Personeli (shoferët dhe operatorët për kamionët dhe venddepozitim);
 - Njësitë e trajtimit të mbetjeve (venddepozitim ose landfill);
 - Venddepozitimet ilegale (përlllogaritje e përgjithshme);
 - ...
- b) **Përlllogaritja e skenarit (duke përdorur modelet e kostos dhe tarifës):**
- Kosto totale për infrastrukturë të re;
 - Kosto totale për personelin;
 - Kosto totale për operacionet dhe mirëmbajtjen;
 - Kosto totale për shërbimin;
 - Kosto për ton dhe kosto për banorë / për komponentë të ndryshëm të shërbimit;
 - Kosoto për aktivitetet e pastrimit (%);
 - Kosto administrative, trajnimi dhe edukimi (%).
- c) **Përcaktimi i përballueshmërisë duke marrë në konsideratë informacionin e mëposhtëm:**
- Përqindja e kostos që zë ofrimin shërbimit tek buxheti i përgjithshëm i bashkisë;
 - Tarifat për tre grupet e gjenerimit të mbetjeve (popullsia, bizneset dhe institucionet);
 - Hendeku në investime (në lek) për çdo komponent të shërbimit;
 - Përqindja e rritjes së tarifës nga situata aktuale për çdo komponent të shërbimit (grumbullim, transportim dhe trajtim);
 - Hendeku në tarifë (në lek, krahasuar me tarifën aktuale).

Një diskutim politik duhet të kryhet për të vlerësuar realizueshmërinë e zbatimit të një opsioni apo të tjerëve, në përputhje me rritjen e tarifës. Skenari final, i zgjedhur për zbatim duhet të marrë në konsideratë koston që mund të mbulohet nga tarifa e ardhshme e miratuar (vetë-mjaftueshmëria dhe përballueshmëria). Propozohet të llogaritet kostoja për skenarin e zgjedhur dhe për skenarin "e përputhshmërisë ligjore", për të treguar hendekun.

1.5.2 HAPI 3: Përcaktimi i një objektiv 5-vjeçar për secilin komponent të shërbimit (bazuar në skenarin e zgjedhur)

Bazuar në skenarin e zgjedhur, mund të konsiderohen hapat e ndërmjetëm.

- Vendosja e objektivave specifike dhe përcaktimi i hapave të ndërmjetëm (viti parë, pas 3 vjetësh dhe 5 vjetësh);
- Zhvillimi i synimeve bazuar në të njëjtin sistem të indikatorëve të shpjeguar më lart (psh në vitin 2017, 98% e territorit do të jetë e mbuluar nga shërbimi);
- Të merret në konsideratë infrastruktura që do të investohet në çdo fazë (numri i kamionëve dhe koshave, ose infrastruktura të tjera);
- Të merret në konsideratë kapaciteti financiar në futjen e hapave për të arritur parimin "Tarifa duhet të mbulojë koston";
- Të merret në konsideratë përputhshmëria ligjore në një nivel sa më të mirë të mundshëm (ndarja, rikuperimi, trajtime special, etj);
- Të merret në konsideratë zhvillimi i kapaciteteve (trajtime), edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit, aktivitetet e pastrimit.

Një plan biznesi duhet të zhvillohet, duke marrë parasysh:

- Investimet e nevojshme për secilin hap;
- Koston e shërbimit për secilin hap;
- Mbledhja e tarifës, duke përfshirë edhe interesat e kredisë, nëse kjo është e nevojshme për të financuar investimet.

Përkthimi i objektivave 5-vjeçare në objektivin e performancës, siç është propozuar në shembullin e mëposhtëm:

Tabel4: Vendosja e objektivave bazuar tek indikatorët

| | | | Aktualet | Objektivat përballeshëm e |
|---------------------------------|----|--|------------|---------------------------|
| Cilësia e shërbimit | C1 | Zona e mbuluar me shërbim | | |
| | | C1.1 Mbulimi me shërbim në zonat urbane dhe peri-urban | 60% | 90% |
| | | C1.2 Mbulimi me shërbim në zonat e largëta/izoluara | 20% | 60% |
| | C2 | Pastërtia e qytetit | 50% | 70% |
| | C3 | Perceptimi publik: shkalla e kënaqësisë | 30% | 60% |
| Qëndrueshmëria mjedisore | D1 | Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve | E panjohur | 5% |
| | D2 | Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfillet inxhinierikë dhe zonat e miratuara dhe kontrolluara për depozitim | 30% | 70% |
| Qëndrueshmëria Financ&Instituc. | E1 | Mbulimi i kostos: Tarifa mbulon koston | 30% | 100% |
| | E2 | Si qytetari mund të kontribuojë në financimin e shërbimit: shkalla e mbledhjes së tarifave | 50% | 80% |
| | E3 | Transparenca e sistemit të faturimit | I ulët | Mesatare |
| Kosto e shërbimit | | Lek/t | xxx | xxx |
| | | Lek / banorë / vit | xxx | xxx |

Objektivat e vendosura nga bashkia duhet të jenë të arritshme duke konsideruar kushtet reale dhe mundësitë në të cilat ndodhet njësia vendore.

Sipas përkufizimit, një objektiv, është shprehje e qartë për atë që ju keni planifikuar të arrini, e cila është e vlerësuar nga ana sasiore dhe e vendosur në një interval kohor specifik. Ekzistojnë tre tipe objektivash:

- Objektiva për produktin;
- Objektiva për rezultatin;
- Objektiva për impaktin.

Në çdo lloj programi për monitorimin, çdo NjQV duhet të ketë të paktën një objektiv për impaktin, pasi kjo është e vetmja mënyrë për të matur rezultatet e çdo aktiviteti/operacioni në menaxhimin e mbetjeve.

| Produkt | Rezultat | Impakt |
|--|---|---|
| Objektiva për produktin | Objektiva për rezultatin | Objektiva për impaktin |
| Kjo nënkupton që aktivitetet janë kryer për të prodhuar një rezultat. Është e lehtë për të matur përpjekjet tuaja por jo atë që ju keni arritur. | Këto nënkuptojnë ndryshimet që mund të ndodhin si rezultat i përpjekjeve tuaja. Shpesh herë ju keni nevojë për të bërë supozime teorike kur përcaktoni një objektiv të tillë. | Këto janë rezultatet përfundimtare për aktivitetet e NjQV. Për shembull, ndryshimi në sjellje për banorët rezulton në më tepër njerëz që marrin pjesë në programet e riciklimit e për rrjedhojë riciklimi është rritur. |
| Shembull: Shpërndarja e 300 koshave shtesë për të prezantuar grumbullimin e diferencuar në NJQV. | Shembull: Supozimi që shpërndarja e 300 koshave më tepër do të rezultojë në një ndryshim, psh të sigurojmë që 5000 banorë më tepër janë të ndërgjegjësuar për skemën e grumbullimit të ndarë të mbeturinave. | Shembull: 1,200 familje më tepër marrin pjesë në skemën e riciklimit. Tonazhi i materialeve të ricikluara është rritur me 2% në vit. |

Për të matur këto objektiva është shumë e lehtë – thjesht është një numërim se çfarë NjQV kanë bërë, kontrollimi i cilësisë së materialeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar ose matja e tonazhit të materialeve të ricikluara çdo vit. Ndaj është e rëndësishme që kur ne hartojmë objektivat të sigurohemi që kemi hartuar objektiva SMART.



Figura 6: Hartimi i objektivave SMART

Specifike. Është e rëndësishme që një objektivi duhet të jetë i qartë dhe jo shumë ambicioz, kështu që do të jetë i thjeshtë për t’u kuptuar se çfarë është e përfshirë në arritjen e tij. Mos supozoni që do ketë një mirëkuptim të përbashkët të një objektivi ndërmjet aktorëve të ndryshëm; çdo term që është përdorur duhet të qartësohet.

Për shembull, një objektivi si: an objective like: “Të përmirësojmë performancën e skemës së riciklimit” është shumë ambicioz dhe është aktualisht një qëllim për NjQV që dëshiron për të rritur normën e riciklimit. Përnjëherësh shumë paqartësi do të shfaqen, si: cilat aspekte NjQV do të përmirësojë? A bëhet fjalë për normën e riciklimit, normën e pjesëmarrjes së aktorëve në skemë, apo për eficientësi operacionale të shërbimit? A bëhet fjalë për grumbullimin e mbetjeve organike, për grumbullimin e të riciklueshmeve të thata, sistem ku mbetjet sillen nga qytetarët?

Të matshme. Objektivat duhet të jenë të matshme në praktike dhe jo thjesht në teori. Është e rëndësishme që të kemi një informacion fillestar për aspekte të ndryshme për çdo lloj operacioni në menaxhimin e mbetjeve, kështu që përmes programit të monitorimit do të jetë e mundur për të matur dhe vlerësuar performancën e këtyre objektivave specifike.

Për shembull, aktualisht është e mundur për të matur tonazhin e mbeturinave të grumbulluara për çdo intenerar grumbullimi, kështu që mund të marrim informacion në lidhje me eficientësinë e përdorimit të kamionit, duke matur kohën dhe performancën e aktivitetit të grumbullimit, ose sasinë e materialeve të riciklueshme në qoftë se autoritetet lokale kanë implementuar sistemin e grumbullimit me dy kosha.

Për këto arsye është shumë e rëndësishme që për sistemin e monitorimit të kemi hartuar objektiva që në fund të mund të maten shumë lehtë.

Të arritshme. Ku hartohet një objektivi ose një target specifik, pyetja më e rëndësishme që NjQV duhet të bëjnë është – a është e mundur që objektivi të arrihet? A është e mundur, për shembull, të rrisim normën e riciklimit me 20% në tre muaj? Po në gjashtë muaj ose në një vit a është një interval kohor më i mundur? Në qoftë se ne kemi të dhëna me një cilësi të mirë dhe të besueshme, do të kemi mundësi të kuptojmë në qoftë se objektivat që kemi hartuar janë të arritshme apo jo.

Të përshtatshme. Objektivat duhet të jenë të lidhura me qëllimin e programit të monitorimit. Në qoftë se ato nuk janë, atëherë ato nuk janë relevante. Pra NjQV duhet të jenë të sigurt në qoftë se objektivat janë të rëndësishme për ato që ata përpiqen të arrijnë LGUs must make sure if the objectives are important to what they are trying to achieve? Are LGUs objectives' going to help them to achieve their goal?

Për shembull, objektiva e një fushate komunikimi për të shpërndarë fletë palosje për të dhënë informacion rreth riciklimit nuk do ta përmirësojë performancën në qoftë se problem është që banorët nuk kanë mungesë njohurish për shërbimin. Arsyeja për një performancë të ulët mund të jetë diçka e lidhur me vetë shërbimin, ose me sipërfaqen që mbulon grumbullimi i diferencuar i materialeve të riciklueshme.

Të kufizuara në kohë. Objektivat duhet të kenë një limit kohor se kur ato duhet të realizohen. Kjo e bën më të lehtë matjen e suksesit ose dështimit dhe në të njëjtën kohë na paraqet një fokus se ku duhet të përqëndrohen përpjekjet. Për shembull, është një praktikë e mirë të vendosësh një datë në të cilën NjQV presupozon që objektiva duhet të jetë plotësuar. Afati kohor duhet të jetë i përshtatshëm dhe relevant me tipin dhe natyrën e objektivës që NjQV kanë vendosur.

1.5 Shpjegimi i indikatorëve të performancës dhe metodat e llogaritjes së tyre

Sistemi i indikatorëve të performancës është zhvilluar për t'u përdorur si monitorues i cilësisë për shërbimin e ofruar në nivel bashkie. Kjo ndihmon në ofrimin e një tabloje të qartë të situatës aktuale dhe objektivave të vendosura për t'u arritur.

Indikatorët janë vlerësuar në fillimin të procesit të planifikimit dhe janë rishikuar çdo vit, për të monitoruar performancën. Ata prezantohen çdo vit në këshill.

Ata do të përdoren të paktën në fillim të procesit të planifikimit dhe si indikatorë për përcaktimin e objektivave të planit. Bashkia duhet të bëjë matjen e indikatorëve në baza vjetore për të kuptuar zhvillimet dhe për të përshtatur objektivat sipas nevojës.

Para matjes së indikatorëve të mundësuar në tabelë është i nevojshëm dokumentimi i informacionit të mëposhtëm:

- (1) Tipologjia e bashkisë dhe diversiteti përgjatë njësive të ndryshme administrative;
- (2) Si është shërbimi i ofruar nga një kompani publike ose PPP;
- (3) Çfarë është kostoja për banorë dhe kosto për ton.

Tabela më poshtë tregon grupin e zgjedhur të indikatorëve që reflektojnë performancën në menaxhimin e mbetjeve.

Tabela5 :Grupi i indikatorëve të performancës

| Indikatorët | | Klasifikimi i koduar me ngjyra | | | Saktësia e të dhënave |
|---|---|--------------------------------------|-----------|------------|-----------------------|
| | | I ulët | I mesëm | I lartë | |
| Cilësia e Shërbimit | C1 Zona e mbuluar me shërbim | | | | |
| | <i>C1.1 Mbulimi me shërbim në zonat urbane dhe peri-urban.</i> | 0 – 40 % | 41 – 80% | 81 – 100% | |
| | <i>C1.2 Mbulimi me shërbim në zonat e largëta/të izoluara.</i> | 0 – 30 % | 31 – 50% | 51 – 100% | |
| | C2 Pastërtia e qytetit. | 0 – 32 % | 33 - 66% | > 66% | |
| | C3 Perceptimi publik: Shkalla e kënaqshmërisë publike me shërbimin. | 0 – 50% | 51% - 80% | 81% - 100% | |
| Qëndrueshmëria mjedisore | D1 Ripërdorimi: Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në zonat urbane. | 0 – 5% | 5 – 20% | >20% | |
| | D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: Shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfillet inxhinierikë dhe zonat e miratuara dhe kontrolluara për depozitim. | 0 – 30% | 31 – 70% | 71 – 100% | |
| Qëndrueshmëria e institucioneve ekon.&financ. | E1 Mbulimi i kostos: Tarifa mbulon koston. | 0 – 35% | 36 – 70% | 71 – 100% | |
| | E2 Si qytetarët mund të kontribuojnë në financimin e shërbimit: Shkalla e mbledhjes së tarifave. | 0 – 40% | 41 – 75% | 75 – 100% | |
| | E3 Transparenca e sistemit të faturimit. | I ulët | I mesëm | I lartë | |
| Kosto e shërbimit | |Lek/tLek /banorë / vit | | | |

Mënyra e llogaritjes së secilit indikator prezantohet në kapitujt e mëposhtëm.

Performanca është vlerësuar duke marrë në konsideratë tri shtylla kryesore:

- Cilësia e shërbimit;
- Qëndrueshmëria mjedisore;
- Qëndrueshmëria financiare dhe institucionale.

Kolona e fundit "saktësia e të dhënave" jep një informacion mbi nivelin e besueshmërisë së të dhënave, sipas mënyrës që është mbledhur informacioni. Zbatimi i një mjeti monitorimi do të ndihmojë bashkisë matjen dhe rregjistrimin e të dhënave. Me kohë, kjo saktësi duhet të rritet.

1.5.1 Indikatorët e cilësisë së shërbimit

Indikatori C1: “Mbulimi me shërbim në zonat urbane dhe gjysëm urbane”

Indikatori C1 tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJQV, nga autoritetet e autorizuar që të kujdesen për shërbimin, mbi totalin e sasisë së mbetjeve të gjeneruara në NJQV. Ky indikator është ndarë në 2 nën indikatorë, duke pasqyruar zonat urbane/peri urbane (C1.1) dhe zonat e largëta (C1.2).

Formula

$$C1.1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara në zonat urbane \& periurbane } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve të gjeneruara në zonat urbane \& periurbane } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

$$C1.2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara në zonat e largëta } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve të gjeneruara në zonat e largëta } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë së tyre

Ky indikator është gjërësisht i sugjeruar nga literatura për t’u përdorur në matjen e efikasitetit të grumbullimit të mbetjeve. Megjithatë, besueshmëria në këtë indikator ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në varësi të metodave të përdorura për gjenerimin e të dhënave.

| Gjenerimi i mbetjeve | Grumbullimi i mbetjeve | Shkalla e saktësisë/ besueshmërisë |
|--|--|---|
| Bazuar në shtrirjen e bashkisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM). | Nuk ka matje, vlerësimi me hamendje ose i bazuar në një sondazh të veçantë. | E ulët |
| Bazuar në shtrirjen e qytetit dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM). | Vlerësimi nga numri i rrugëve të kryera dhe tonazhit të automjeteve drejt zonës së depozitimit. | E mesme |
| Gjenerimi i mbetjeve është vlerësuar nga kampionet e marra të mbetjeve. | Matja në peshoret që ndodhen në fushën e depozitimit (dhe në çdo impiant trajtimi sipas rastit-kompostimi, riciklimi dhe landfilli). | E lartë |

Indikatori C2: “Pastërtia e qytetit”

Indikatori C2, efektshmëria e grumbullimit të mbetjeve dhe pastrimit të rrugëve, është një indikator cilësor kompleks, i cili është i detajuar nga 3 kriteret e vlerësimit. Përshkrimi i secilit kriter dhe metoda e llogarimit janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Formula

$$C2 = C2.1 + C2.2 + C2.3$$

| N° | Kriteri | Përshkrimi | Vlerësimi |
|------|---|---|---|
| C2.1 | Efektshmëria e grumbullimit të mbetjeve | Prezenca e mbetjeve të akumuluar rreth kontejnerëve/pikave të grumbullimit. | Prezencë e lartë mbetjesh (shumë e dukshme)0 Prezencë e moderuar e mbetjeve (sporadike)16 Prezencë e ulët e mbetjeve (pothuajse asgjë)33 |
| C2.2 | Efektshmëria e pastrimit të rrugëve | Prezenca e mbetjeve në rrugë | Prezencë e lartë mbetjesh (shumë e dukshme) 0 Prezencë e moderuar e mbetjeve (sporadike) 16 Prezencë e ulët e mbetjeve (pothuajse asgjë) 33 |
| C2.3 | Efektshmëria e grumbullimit në zonat e largëta/të izoluara | Prezenca e mbetjeve të akumuluar/vend-depozitimet ilegale/djegia e mbetjeve në zonat e largëta/periferi | Prezencë e lartë mbetjesh (shumë e dukshme) 0 Prezencë e moderuar e mbetjeve (sporadike) 16 Prezencë e ulët e mbetjeve (pothuajse asgjë) 33 |

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë

| Vlerësimi i prezencës së mbetjeve | Saktësia/ besueshmëria |
|---|------------------------|
| Intervistë me personat përgjegjës të bashkisë | E ulët |
| Sondazhi i kufizuar në terren | Mesatare |
| Raportim i rregullt mbi shërbimin (ditore/javore/mujore), të realizuara nga bashkia | E Lartë |

Indikatori C3: "Perceptimi publik"

Indikatori C3 është përshkruar si një indikator i cilësisë për bashkinë. Qytetarët do të pyeten për të siguruar të dhëna mbi perceptimin e tyre për shërbimi, bazuar në një pyetje të bërë gjatë procesit të planifikimit dhe rishikimit rregullisht.

Një pyetje do të shërbejë për të llogaritur indikatorët: "A është shërbimi i grumbullimit të mbetjeve i kënaqshëm për grumbullimin në shtëpinë/lagjen tuaj? Përgjigja "Po" ose "Jo".

Formula

$$C3 = \frac{\text{Numri i përgjigjeve Po}}{\text{Numri i personave të pyetur}} \times 100$$

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë

| Kryerja e studimit | Saktësia/ besueshmëria |
|--|---------------------------------------|
| Rregullat e statistikës tregojnë numrin e personave që duhet të intervistohen, në bazë të madhësisë së popullsisë totale, për të marrë informacion përfaqësues (me 5% gabim) | |
| Numri i popullsisë | Mostra e nevojshme për anketim |
| • 1'000 | 200 |
| • 5'000 | 257 |
| • 10'000 | 263 |
| • 100'000 | 270 |
| Mostra e zgjedhur nuk është përfaqësuese për popullsinë | E ulët |
| Mostra e zgjedhur është përfaqësuese e popullsisë | E lartë |

1.5.2 Indikatorët e qëndrueshmërisë mjedisore

Indikatori D1: “Shkalla e ripërdorimit - grumbullimi i diferencuar i mbetjeve”

Indikatori D1 përfaqëson raportin e sasisë së mbetjeve, të cilat janë mbledhur zyrtarisht nga një cikël i mbyllur nga pikat e grumbullimit për tek qendra e trajtimit.

Sasia do të përfaqësojë të gjitha llojet e mbetjeve të ndara nga secila pale e autorizuar, nga niveli i gjenerimit, niveli i mbledhjes ose në nivel të trajtimit.

Ajo është krahasuar me sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara.

Formula

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara veçmas [t/vit]}}{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara [t/vit]}} \times 100$$

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë

| Grumbullimi i mbetjeve | Shkalla e saktësisë/ besueshmërisë |
|--|--|
| Asnjë matje, vlerësim i hamendësuar ose i bazuar në një sondazh të veçantë. | E ulët |
| Vlerësimi i numrit të udhëtimeve të bëra dhe tonazhit të automjeteve drejt zonës së depozitimit. | Mesatare |
| Matja në peshoren që ndodhen në zonën e depozitimit (dhe në çdo impiant trajtimi, kur është e mundur- kompostimi, riciklimi dhe landfilli). Raportim i rregullt. | E lartë |

Indikatori D2: “Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfillet inxhinierike ose në zonat e depozitimit të kontrolluara dhe aprovuara”

Ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve të trajtuara në qendrat e autorizuara (landfill ose vend - depozitim të autorizura, impiante të kompostimit ose riciklimit).

Formula

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të trajtuara siç duhet}}{\text{Sasia totale e mbetjeve të grumbulluara}} \times 100$$

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë së tyre

Shkalla mbi besueshmërinë e propozuar për indikatorin D1 mund të aplikohet edhe për D2.

1.5.3 Indikatorët e qëndrueshmërisë institucionale, ekonomike dhe financiare

Indikatori E1: “Mbulimi i kostos nëpërmjet tarifave”

Ky indikator krahason koston totale për ofrimin e shërbimit dhe financimin e tij me anë të normës së tarifave të miratuara dhe mbledhjes së tyre.

Formula

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore të MM që vijnë nga tarifat} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kosto vjetore e operimit të shërbimit} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë

| Kosto dhe të ardhurat nga tarifat | Saktësia/ besueshmëria |
|---|-----------------------------------|
| <p>Kosto e shërbimit: Buxheti është llogaritur si shumë totale, pa ndonjë sistem të kostove të ndara. Bashkia përdor informacion të përgjithshëm mbi llogaritjen e koston.</p> <p>Të ardhurat: Tarifa është një e dhënë historike, nuk është e llogaritur specifikisht për të mbuluar koston, fianancat e bashkisë nuk lejonë të njihet në mënyrë të saktë cila pjesë e tarifës është grumbulluar.</p> | E ulët |
| <p>Kosto e shërbimit: Buxheti merr në konsideratë disa zëra të lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe ekziston një sistem i thjeshtë për llogaritjen e koston.</p> <p>Të ardhurat: Tarifa është një e dhënë historike, nuk është llogaritur specifikisht për të mbuluar koston.</p> | Mesatare |
| <p>Kosto e shërbimit: Kostoja është llogaritur në bazë të një llogaritjeje të plotë të saj, duke përfshirë operimin, amortizimin dhe kosto administrative.</p> <p>Të ardhurat: Tarifa është llogaritur bazuar në një metodologji të qartë. Ka një tarifë të veçantë për gjenerues të ndryshëm (qytetarët, bizneset, institucionet, ...). Llogaritë për vendosjen e tarifave dhe shkallën e arkëtimit janë të qarta.</p> | E Lartë |

Indikatori E2: “Kontributi i qytetarëve në financimin e shërbimit: niveli i mbledhjes së tarifës të miratuar”

Ky indikator reflekton kapacitetin/gatishmërinë e popullsisë për të paguar tarifën.

Formula

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga MM nëpërmjet tarifave } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Të ardhurat totale të planifikuara } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Të dhënat që do të përdoren dhe vlerësimi i besueshmërisë

| Niveli i grumbullimit | Saktësia/ besueshmëria |
|---|-----------------------------------|
| Vlerësimi i bashkisë. | E ulët |
| Llogaritë transparente (sistem financiar analitik). | E lartë |

Indikatori E3: “Transparenca e sistemit të faturimit”

Ky indikator vlerëson kapacitetin e bashkësisë për të mundur një faturë për të gjithë gjeneruesit e mbetjeve.

Formula

Ky është një indikator cilësor, i vlerësuar sipas tabelës së mëposhtme.

| Transparenca e sistemit të faturimit | Saktësia/ besueshmëria |
|---|-----------------------------------|
| Nuk ka një sistem faturimi për tarifën e mbetjeve. | E ulët |
| Ekziston një sistem faturimi, gjeneruesit marrin një faturë. | Mesatare |
| Ekziston një sistem faturimi. Qytetarët kanë akses në informacion për të kuptuar llogaritjen e tarifës. Mënyra sesi është llogaritur tarifa është e qartë dhe transparente për gjeneruesit e mbetjeve | E lartë |

KAPITULLI 2: MONITORIMI I SHËRBIMIT

2.1 Hyrje

Pas zhvillimit të procesit të planifikimit të bazuar në performance, së bashku me të gjithë treguesit që përdoren për të monitoruar performancën në baza vjetore (makro) të bashkisë, ky kapitull është fokusuar në monitorimin e çdo operacioni të menaxhimit të mbeturinave në një shkallë më të vogël, çdo ditë ose çdo javë.

Ky kapitull synon të përshkruajë procesin dhe hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren nga ekspertët në NJQV-të kur është planifikuar një sistem monitorimi për çdo operacion të menaxhimit të mbeturinave. Ai ofron metodologjinë se si duhet të hartohet një sistem operacional monitorimi, i cili analizon të gjitha palët e interesuara, pra të gjithë aktorët që marrin pjesë në operacionet e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, detyrimet dhe ndërlidhjen e tyre apo proceset që përfshihen në dhënien e shërbimit në nivel lokal në të dyja rastet, si kur shërbimi ofrohet nga bashkia ashtu edhe në rastin kur ai ofrohet nga një operator privat.

Kapitulli përshkruan në detaje çdo hap dhe jep informacionin e nevojshëm për t'u ndjekur nga çdo ekspert, duke e orientuar atë në identifikimin e problemit dhe në marrjen e vendimit sesi duhet zgjidhur ai, e shoqëruar kjo me shembuj konkretë dhe raste studimore nga realiteti lokal.

2.1.1 Përse NJQV duhet të realizojë monitorimin e performancës së shërbimit?

Monitorimi ditor i operacioneve të menaxhimit të mbetjeve (grumbullimi, transporti, riciklimi, kompostimi, sikurse edhe depozitimi përfundimtar) është pjesë e një procesi të vazhdueshëm mësimi dhe përmirësimi, i cili i krijon mundësinë NJQV-ve të vlerësojnë performancën e këtyre operacioneve kundrejt qëllimit dhe objektivave që ato kanë.

Në të gjitha rastet edhe kur shërbimi i menaxhimit të mbetjeve (çdo operacion i përfshirë në të) ofrohet nga vetë bashkia, përmes ndërmarrjeve bashkiake edhe kur ky shërbim është i kontraktuar tek një kompani private, monitorimi efikas dhe vlerësimi do të ndihmojnë LGU-të duke :

- matur progresin e çdo operacioni më vete në menaxhimin e mbetjeve kundrejt objektivave dhe targeteve të dakortësuara në kontratën e shërbimit. Kështu NJQV-të do ta dinjë paraprakisht në qoftë se objektivat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve ka mundësi që të plotësohen ose jo;
- të matur efektivitetin e pajisjeve dhe stafit të përdorur në çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve;
- të hartuar dhe adresuar masa korrektuese dhe rregullatore për të përmirësuar shërbimin, bazuar mbi informacionin e mbledhur përmes monitorimit;
- të vlerësuar shpenzimet dhe për të kontrolluar kostot e çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve, për t'u siguruar që buxheti ekzistues është i shpërndarë në mënyrën e duhur dhe është i mjaftueshëm për të mbuluar kostot e çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve si dhe për të plotësuar objektivat lokale;
- të vlerësuar sjelljen e përdoruesve si dhe matur kënaqësinë e konsumatorit për të parë dhe vlerësuar sesi këto parametra impaktojnë në performancën e shërbimit;
- të planifikuar më mirë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen dhe vlerësuar mundësitë dhe potencialet e zgjerimit dhe riplanifikimit të shërbimit.

2.1.2 Si do t'i ndihmojë ky kapitull NjQV-të për të përmirësuar praktikat e menaxhimit të mbetjeve?

Kjo pjesë e kurrikulës është hartuar për ekspertët e menaxhimit të mbetjeve, të cilët punojnë në nivelin e qeverisjes vendore dhe asaj rajonale. Ekspertët e menaxhimit të mbetjeve që punojnë në iniciativa private gjithashtu mund të përfitojnë nga ky kapitull.

Kapitulli nuk ka për qëllim t'i tregoj lexuesit sesi të përmirësojë performancën apo skemat e ndonjë operacioni të caktuar në menaxhimin e mbetjeve, por për më tepër ai synon të ndihmojë dhe orientojë lexuesin në identifikimin e problemit dhe në marrjen e vendimit sesi duhet zgjidhur ai, gjithmonë e parë kjo në këndvështrimin e rrethanave lokale.

- A jeni ju i përfshirë direkt ose indirekt në ndonjë nga operacionet e menaxhimit të mbetjeve, por ju nuk dini sesa mirë jeni duke e bërë punën?
- A jeni ju pjesë e ekipit apo departamentit të supervizimit të shërbimit?
- A është i përfshirë në punën tuaj raportimi për grumbullimin, transportin, riciklimin, kompostimin apo depozitimin e mbetjeve, fshirja e rrugëve apo larja e tyre etj, dhe ju nuk dini në qoftë se skemat organizative dhe teknike të përdorura për këto operacione në qytetin tuaj janë duke dhënë rezultatet e duhura krahasuar me objektivat e pritshme dhe pse?
- A jeni ju i përfshirë në hartimin e fushatave komunikuese dhe informuese, apo jeni ju pjesëmarrës në ndonjë projekt apo iniciativë që financohet nga fonde të brendshme apo të jashtme (buxhet nga qeveria ose nga donatorët), të cilët duhet të monitorohen për të matur impaktin e tyre?

Në qoftë se përgjigja për të gjitha pyetjet e mësipërme është PO atëherë ju duhet të ndiqni këtë trajnim. Ndërkohë në qoftë se përgjigja e pyetjeve të mësipërme nga ju është "Nuk e di, nuk jam i sigurt", ju patjetër duhet të ndiqni këtë trajnim.

2.1.3 Hapat kryesor të sistemit të monitorimit

Sistemi i monitorimit të performancës është një cikël i mbyllur dhe i vazhdueshëm përmirësimesh, i cili përbëhet nga hapat e mëposhtëm, siç paraqiten në figurë.




Figura 7: Hapat kryesor në sistemin e monitorimit të performancës

2.2 Qëllimi dhe objektivat e monitorimit

Monitorimi dhe vlerësimi i çdo aktiviteti është një element shumë i rëndësishëm në procesin e planifikimit të çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve. Një sistem i mirë monitorimi do të ndihmojë bashkinë në menaxhimin më të mirë të burimeve financiare, pasi nëpërmjet zbatimit të drejtë të tij do të përmirësohet procesi i planifikimit dhe në të njëjtën kohë përdorimi më i mirë i burimeve.

Megjithatë ky hap shpesh herë neglizhohet nga NJQV si pasojë e mungesës së planifikimit të burimeve njerëzore dhe financiare që në procesin e planifikimit. Për të mundur ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi monitorimi në të gjitha aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve, NJQV në buxhetin vjetor të tyre duhet të kenë një zë të veçantë buxheti vetëm për këtë qëllim. Gjithashtu, pas përcaktimit të buxhetit, burimet njerëzore janë mjaft të rëndësishme për të pasur një sistem funksional dhe efektiv të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së shërbimit. NJQV-të duhet të punësojnë staf të dedikuar me aftësitë përkatëse vetëm për monitorimin dhe vlerësimin, e shoqëruar kjo me terma të përcaktuara specifike, plan pune dhe burime të tjera ndihmëse të nevojshme (mjete për të qarkulluar etj).

Një nga arësyet kryesore pse çdo NJQV duhet të ndërmarrë monitorimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve është për të kuptuar sesi ai shërbim (çdo operacion e pjesë përbërëse e tij) është duke performuar dhe ku janë (identifikimi) mundësitë e përmirësimit të tij.

Pasi janë përcaktuar strukturat që do të merret me monitorimin dhe vlerësimin e performancës së shërbimit të pajisura me burimet e nevojshme financiare dhe humane, hapi tjetër përpara se të fillojë procesi i monitorimit është hartimi i qëllimit, targeteve dhe objektivave për çdo aktivitet dhe nënaktivitet që do të monitorohet.

Kur operacionet e menaxhimit të mbetjeve ofrohen nga ndërmarrjet bashkiake, qëllimi i sistemit të monitorimit duhet të jetë:

- Optimizimi i çdo operacioni (mbledhje, grumbullim, transport dhe depozitim) për t'u bërë kosto efektive;
- Rritja e efektivitetit të çdo operacioni duke përdorur sa më mirë burimet që ndërmarrja ka në dispozicion (efiçenca në përdorimin e burimeve, stafit dhe paisjeve);
- Matja e progresit në kohë për çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve kundrejt objektivave dhe targeteve të dakortësuara në Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.
- Krijimi i një sistemi informacioni për mbetjet sipas indikatorëve të monitorimit që do të shërbejnë edhe për procesin e planifikimit.

Kur të gjitha ose ndonjëri prej operacioneve të menaxhimit të mbetjeve ofrohen nga ndonjë palë e tretë (kompani private) objektivat kryesor të sistemit të monitorimit të performancës duhet të jenë:

- Në qoftë se të gjithë komponentët dhe targetet e dakortësuara në kontratë për çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve janë plotësuar;
- Për të lehtësuar raportimin dhe komunikimin ndërmjet çdo personi përgjegjës në sistem dhe bashkisë;
- Për të krijuar një sistem informacioni që do të përmirësonte procesin e planifikimit;
- Të verifikojë në qoftë se njësia publike realizon apo jo detyrat kontraktuale/detyrat e caktuara në kontratë.

2.3 Aktorët e përfshirë në nivelin lokal

Hapi i dytë në sistemin e monitorimit për vlerësimin e performancës së shërbimit të ofruar është identifikimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë shërbim. Me qëllimin për të arritur përmirësimin e efikasitetit të shërbimit, në të dy rastet, si kur shërbimi ofrohet nga bashkia, ashtu edhe kur ai është i kontraktuar, është e rëndësishme të bëhet dallimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në secilin operacion që parashikohet në ndonjë marrëveshje apo kontratë si dhe të analizohen detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Në seksionin 2.5 shpjegohet në mënyrë më të detajuar, nëpërmjet një rasti studimor nga Bashkia e Shkodrës, cilat janë në përgjithësi aktorët kryesorë të përfshirë në operacionet e menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal dhe se si detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë të lidhura në procesin e monitorimit të shërbimit në nivel lokal.

2.4 Zhvillimi i skemës së monitorimit të performancës

Pas identifikimit të gjithë aktorëve të përfshirë në operacionet e menaxhimit të mbetjeve dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe detyrave të tyre në funksion të monitorimit është momenti për të hartuar skemën e monitorimit. Çdo skemë monitorimi në përgjithësi përfshin katër faza kryesore, të cilat janë: a) grumbullimi i të dhënave, b) analizimi i të dhënave, c) identifikimi i përmirësimeve dhe d) hartimi i masave korrektuese.

Sistemi i monitorimit të performancës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve është një proces i vazhdueshëm dhe i mbyllur, i cili e ndihmon bashkinë në përmirësimin e shërbimit dhe më vonë në një planifikim më të mirë të tij.

2.4.1 Mbledhja e të dhënave

Përpara se të fillojë me mbledhjen e të dhënave, NjQV duhet të kenë saktësuar qëllimin dhe objektivat si për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve që duan të vlerësojnë ashtu edhe për sistemin e monitorimit që duan të vlerësojnë.

Objekti i mbledhjes së të dhënave është të:

- Vlerësojë cilësinë e shërbimit dhe të identifikojë hapësirat për përmirësim;
- Verifikojë që kompania është duke përmbushur detyrimet kontraktuale (rasti i shërbimit të kontraktuar);
- Verifikojë që njësia e pastrimit është duke plotësuar detyrat sipas përshkrimit të punës (rasti i shërbimit publik).

Në të dyja rastet, edhe kur operacionet e menaxhimit të mbetjeve ofrohen nga bashkia, edhe kur ato janë të kontraktuara tek një operator privat, procesi i grumbullimit të të dhënave duhet të fokusohet tek:

- Sasia totale e mbeturinave e prodhuar në NjQV e shprehur kjo në ton/vit;
- Sasia totale e mbeturinave urbane të grumbulluara dhe të transportuara në kg ose ton/vit;
- Sasia totale e rrymave të ndryshme të mbetjeve që grumbullohen dhe transportohen në mënyrë të diferencuar (kg or ton/vit);
- Sasia e mbetjeve të riciklueshme dhe të kompostueshme;
- Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill/vend depozitim;
- Sipërfaqet e rrugëve që duhen fshirë në mënyrë mekanike dhe automatike dhe frekuencat përkatëse;
- Sipërfaqet e rrugëve që duhen larë dhe frekuencat e tyre;
- Numri i pikave të grumbullimit dhe numri i kazanëve për çdo pikë grumbullimi;
- Koha dhe frekuenca e grumbullimit të kazanëve sikurse edhe gjendja fizike e tyre;
- Koha dhe frekuencat e fshirjes dhe larjes së rrugëve;
- Intenerarët e grumbullimit të mbeturinave dhe orët e operimit të çdo kamioni.

Ekzistojnë metoda të ndryshme për të gjeneruar disa prej të dhënave të specifikuar më sipër. Për shembull, njëra prej metodave mund të jetë vëzhgimi i drejtëpërdrejtë në terren, ose matjet dhe llogaritjet e bazuara në disa supozime kryesore, apo marrja e kampioneve të mbetjeve, studimi dhe analizimi e më pas gjeneralizimi i rezultateve apo edhe peshimi direkt i mbetjeve etj. Gjithësesi

metoda e përdorur për të gjeneruar të dhënat varet nga mjetet financiare që NjQV posedojnë apo vënë në dispozicion për monitorimin. Për shembull:

a) Për të gjeneruar të dhëna mbi sasinë e prodhimit të mbetjeve NjQV mund të përdorin metodat e rreshtuara sipas shkallës së besimit:

- Prodhimi i mbetjeve vlerësohet mbi bazën e të dhënave empirike të sugjeruara, në varësi të madhësisë së qytetit, siç janë përshkruar edhe në planin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve;
- Prodhimi i mbetjeve vlerësohet mbi kampionimin e mbetjeve (kampionet janë statistikiisht përfaqësues) të cilët janë marrë në çdo sezon të vitit, për çdo kategori që përfiton shërbimin (të paktën 1 herë në 3 vjet).

b) Për të gjeneruar të dhëna mbi grumbullimin e mbeturinave:

- Bazuar mbi numrin e kazanëve të grumbulluar dhe vlerën mesatare të sasisë së mbeturinave që mund të mbajë një kazan;
- Bazuar mbi numrin e rrugëve të realizuara nga një kamion dhe kapacitetit të tonazhit të tij.

Për të gjeneruar të dhëna mbi sasinë e mbeturinave të grumbulluara në mënyrë të diferencuar:

- Grumbullimi i veçuar i mbetjeve vlerësohet nga ofruesi i shërbimit pa ndonjë dokumentacion shoqëruar dhe i pa bazuar në ndonjë metodologji matjeje;
- % e përfituesve të shërbimit, të cilët janë të pajisur me infrastrukturën përkatëse (sistemi me dy ose tre kosha) përdoret si bazë për të vlerësuar sasinë e grumbullimit të veçuar të mbeturinave;
- Vlerësimi i sasisë së grumbulluar është i bazuar në të dhënat e grumbulluara nga autoritetet e angazhuara në grumbullimin e veçuar (pikat e grumbullimit të rrymave të ndryshme), të shoqëruara me dokumentacionin përkatës;
- Sasia e veçuar e mbetjeve në ditë që arrin në impiantet e trajtimit, e cila është e matur me peshore, duke u bazuar tek pesha e çdo makine për çdo udhëtim. Kësaj sasia duhet t'i shtohet sasia e mbetjeve të tërhequra nga sistemi i grumbullimit nga sektori informal.

c) Për të gjeneruar të dhëna mbi sasinë e mbetjeve që depozitohen në vend depozitim:

- Të dhënat merren duke u bazuar mbi numrin e kamionëve dhe të udhëtimeve të tyre drejt landfillit;
- Të dhënat gjenerohen duke u bazuar tek bilanci i masës (totali i mbetjeve të grumbulluara–humbjet e lagështisë–sasinë e ricikluar ose të kompostuar);
- Sasia e mbetjeve të mbledhura vlerësohet mbi matjen e tyre në peshoret e vendosura në hyrje të landfillit ose vend depozitimit.

d) Për të gjeneruar të dhëna në lidhje me fshirjen apo larjen e rrugëve:

- Të dhënat merren duke u bazuar në numrin e rrugëve që e marrin këtë shërbim;
- Të dhënat merren duke u bazuar mbi sipërfaqen e rrugëve që realisht përfitojnë këto shërbime;
- Në rastet kur këto shërbime janë të automatizuara, informacioni mund të merret nga një sistem GPS i instaluar në makina. Kur shërbimet janë mekanike, të dhënat mund të gjenerohen nga orët e punës, normativat dhe numri i stafit të përfshirë në këto shërbime.

2.4.2 Analizimi i të dhënave

Të gjitha të dhënat e mbledhura përgjatë fazës së parë mund të jenë të përdorshme nga NjQV vetëm nëse ato analizohen fillimisht për të kuptuar se çfarë ato tregojnë. Ajo që është e nevojshme në këtë fazë është interpretimi i tyre, duke i krahasuar ato me informacionet paraprake ose të dhëna të njëjta të grumbulluara ndër vite apo nga burime të tjera.

Për shembull është shumë e rëndësishme për të krahasuar të dhënat e monitorimit me të dhëna të të njëjtit tip të përdorura në monitorime të mëparshme, që ndonjë NjQV ka bërë për të identifikuar ndonjë trend apo tendencë, siç është për shembull, ngritja apo zbritja e shifrave të shtrira në kohë.

Gjithashtu është e rëndësishme në fazën e analizimit të të dhënave që përpara se të fillojmë grumbullimin e të dhënave, NjQV duhet të kenë në dispozicion të dhëna që përshkruajnë situatën apo operacionet që do të monitorohen nëse ato dëshirojnë të masin ndonjë impakt (për shembull të dhëna përpara dhe pas fushatës së grumbullimit të diferencuar të mbetjeve). Kjo sepse në mungesë të këtyre të dhënave është e pamundur të vlerësoh masën e ndryshimit që është arritur.

Për më tepër NjQV-të duhet të analizojnë dhe duhet të shohin përmes tipeve të ndryshme të të dhënave që ato kanë grumbulluar apo të krahasojnë me njëra tjetrën të dhënat e të njëjtit tip për të kuptuar nëse ato tregojnë ndonjë gjë të rëndësishme në lidhje me identifikimin e shkaqeve ose faktorëve që mund të ndikojnë në performancë.

Kështu për shembull, skema e grumbullimit të mbetjeve është duke performuar keq në zonat periferike të qytetit dhe NjQV ka nevojë të kuptojë diçka më tepër, duke analizuar dhe gjykuar mbi të dhënat e monitorimit për të kuptuar pse. Mund të ketë ndodhur për shembull, që nga lagjet e tjera fqinje mbetjet janë depozituar në të njëjtët kazanë. Kjo gjë ka rezultuar në refuzimin e grumbullimit të këtyre kazanëve (ose të prezencës së mbeturinave përreth tyre) nga ekipi që kryen operacionin e grumbullimit. Kështu që kemi një situatë ku duket sikur grumbullimi nuk performon siç duhet. Ekipi i monitorimit mund ta kuptojë dhe ta interpretojë këtë situatë vetëm duke analizuar dhe parë të njëjtin tip të dhënash të grumbulluara në periudha të ndryshme kohore (për shembull numrin e kontenierëve të grumbulluar në atë zonë, të dhënat e tonazheve të depozituara nga ajo zonë në landfill, kohën e grumbullimit etj). Sigurisht që marrja e informacionit nga ekipi që kryen operacionin e grumbullimit të mbeturinave gjithashtu do të ndihmonte për të qartësuar këtë anomali, por më i rëndësishmi për t'u mbajtur mend është fakti që qëllimi i monitorimit është të identifikojë problemet dhe jo ajo që ju mendoni se problemi është.

2.4.3 Identifikimi i nevojave për të përmirësuar shërbimin

Duke parë dhe analizuar të dhënat e monitorimit, NjQV-të jo vetëm që mund të identifikojnë potencialin për ndryshim të operacioneve të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve për të përmirësuar performance, por edhe mund të identifikojnë praktika të mira të këtij shërbimi. Kështu pas analizimit të të dhënave, NjQV-të mund të dallojnë:

- Cilat aspekte të shërbimit/operacione të menaxhimit të mbetjeve paraqiten që funksionojnë mirë dhe cilat jo?
- Cilat nga zonat që marrin shërbim janë në gjendje më të mirë sesa ka qenë e pritur dhe në cilat zona të qytetit kërkohet shërbim shtesë?
- Cila është përqindja e mbulimit me shërbim dhe në cilat zona ne kemi nevojë për të riprogramuar shërbimin apo për ta prezantuar atë për herë të parë?

Në fund përgjigjet e këtyre pyetjeve do të ndihmojnë NjQV-të në stadin ku janë për të përshtatur sistemet e tyre dhe në të ardhmen për të bërë një planifikim më të mirë. Të dhënat e mbledhura dhe të analizuar nga monitorimi i performancës së shërbimit në fund do t'i tregojë NjQV-ve se sa mirë apo jo ato kanë plotësuar objektivat e tyre të përcaktuara. Sa afër ato janë me plotësimin e tyre dhe përfundimisht, duke i ndihmuar NjQV-të që të jenë më realiste në përcaktimin e objektivave në të ardhmen.

Në këtë kontekst, mbledhja dhe analizimi i të dhënave të grumbulluara nga monitorimi, do t'i krijojë mundësinë NjQV-ve të identifikojnë zonat potenciale ku shërbimi mund të përmirësohet si për shembull:

- A ka zona me një normë të ulët të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave?
- A ka zona të cilat kanë nevojë për pika shtesë grumbullimi apo që nuk janë të mbuluara fare me kazanë?
- A ka zona të veçanta me një nivel të lartë të ndotjes, pika ilegale me mbeturina?
- A ka ndonjë skemë për grumbullimin e diferencuar, e cila plotëson objektivat e grumbullimit të diferencuar?
- A janë të gjitha objektivat e dakortësuara në kontratë për çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve të respektuara nga ofruesi i shërbimit?
- A janë duke u përdorur kamionët në kapacitetet maksimum të tyre si në volum ashtu edhe në terma kohorë?
- A janë kamionët dhe kazanët të pastër dhe në gjendje të mirë pune?

Ekipi i monitorimit në mënyrë që të identifikojë të gjitha çështjet që shkaktojnë një impakt në performancën e çdo një operacioni në menaxhimin e mbetjeve apo të ndonjë elementi të veçantë në ndonjë skemë të menaxhimit të mbetjeve duhet të adresojë këto tipe pyetjesh në lidhje me nivelin e performancës;

- Përfituesit e shërbimit (familjet, bizneset dhe institucionet) a janë të pajisur me çdo gjë që atyre i nevojitet për të marrë pjesë në mënyrë efektive në ndonjë skemë të caktuar të menaxhimit të mbetjeve (për shembull, tipin e kontenierëve të duhur, njohuritë e nevojshme, informacionin mbi ditën dhe orën e grumbullimit, etj.)?
- A ndodhin operacionet e menaxhimit të mbetjeve (grumbullimi, transporti, riciklimi etj.) në mënyrë efektive apo janë të shoqëruara me probleme (për shembull; ka mungesë grumbullimi, tejmbushje të kazanëve komunalë, të njëjtët kontenierë të përdorur edhe për banorët edhe për aktivitetet komerciale, prezencën e kontenierëve të dëmtuar ose mungesë e tyre, etj.)?
- A ka ndonjë faktor të jashtëm, i cili mund të impaktojë nivelin e performancës (për shembull: vandalizma, një rritje e menjëhershme e popullsisë, rritje e menjëhershme e gjenerimit të ndonjë rryme të veçantë të mbetjeve, etj.)?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, ekipi i monitorimit duhet të analizojë burimin e të dhënave siç janë për shembull: raportet e supervisorëve, raportet e kompanisë, ankesat e përfituesve të shërbimit dhe përgjigjet e NjQV-ve, intervistat e ndryshme me fokus grupe të caktuara ose rezultatet e vëzhgimeve dhe studimeve me pyetësor. Mund të ndodhë që ekipi i monitorimit nuk ka informacion të mjaftueshëm për të konkluduar me një opinion të saktë dhe mund të ketë nevojë për të grumbulluar të dhëna shtesë përpara hartimit të konkluzioneve. Është shumë e rëndësishme që të

merrni këtë hap dhe të mos nxitoheni përpara se të hartoni masa apo të vendosni për ndërhyrje konkrete, në ato pika që kanë një potencial të mundshëm për t'u përmirësuar.

2.4.4 Hartimi i masave korrektuese

Shumë nga NJQV-të e kufizojnë sistemin e menaxhimit të mbetjeve vetëm në operacionet e grumbullimit, transportit dhe depozitimit. Megjithatë edhe pse ofrohet një sistem kaq minimalist, ai nuk është as efektiv dhe as eficient. Pajse jo të përshtatshme dhe mungesa e infrastrukturës së duhur për mbetjet rezultojnë në një përdorim ineffektiv të tyre dhe të personelit. Pa një skedulë sistematike të rrugëve të grumbullimit burime të tjera si lënda djegëse dhe koha shpërdorohen. Duke kryer këto operacione nën një buxhet shumë të limituar, NJQV-të "kanë zbuluar" që kombinimi i efekteve dhe faktorëve të mësipërm e ka kthyer grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në një operacion shumë të shtrenjtë për to.

Pasi ekipi i monitorimit ka zbatuar sistemin e monitorimit të performancës dhe ka identifikuar fushat apo problemet në operacionet e menaxhimit të mbetjeve, të cilat kanë potencial të mundshëm për t'u përmirësuar, masat korrektive që mund të ndërmerren janë të shumta, si për shembull:

- Përshtatja e pozicioneve të pikave të grumbullimit;
- Rregullimi i numrit të kazanëve në çdo pikë të grumbullimit sipas nevojave reale;
- Përmirësimi i bazamenteve në pikat e grumbullimit ku qëndrojnë kazanët në mënyrë që të reduktohet koha e grumbullimit të një pike;
- Rihartimi i internerarëve të grumbullimit dhe frekuencave;
- Hartimi i skedualve dhe kontrolleve të rregullta për të mirëmbajtur makinat dhe kazanët;
- Përshtatja e orarit të grumbullimit dhe të fshirjes me kushtet lokale dhe informacionet e marra nga terreni etj.

Qëllimi i të gjitha masave korrektuese është rritja e nivelit të performancës si dhe bërja e të gjitha operacioneve të menaxhimit të mbetjeve, kosto efektive. Kur shërbimi ofrohet nga ndërmarrjet bashkiake, një mënyrë e thjeshtë për të reduktuar koston është të përmirësosh sistemin e grumbullimit. Kjo nënkupton hartimin e internerarëve më efektivë (më të shkurtër), kohë grumbullimi dhe frekuenca të rregullta, mirëmbajtje të rregullt të mjeteve dhe kazanëve, etj. Megjithatë këto masa dhe sidomos kur shërbimi është i kontraktuar, duhet të kombinohen me një sistem të qëndrueshëm dhe rigoroz supervizimi, i cili duhet të marrë në konsideratë edhe aplikimin e sanksioneve dhe ndëshkimeve në rast të mos plotësimit të tyre.

2.4.5 Përdorimi i teknologjisë për supervizimin e shërbimit

Fuqizimi i procesit të grumbullimit të të dhënave në drejtim të monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe jo vetëm është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen sot NJQV-të. Kështu planifikuesit e sitemeve të menaxhimit të mbetjeve, në mënyrë që të hartojnë skema menaxhimi me operacione efektive dhe efikase, kërkojnë të dhëna të plota dhe të besueshme për aspekte të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, aktualisht sistemet e informacionit në çdo NJQV, janë të limituara për sa i përket database-ve të mbetjeve, të cilat shumë pak menaxhohen si nga njësitë ashtu edhe nga operatorët e shërbimit.

Një mënyrë për të adresuar këtë kërkesë emergjente në menaxhimin e të dhënave për mbetjet, "sisteme gjurmimi", të cilat përdorin teknologjitë e avancuara të informacionit si, RFID (identifikimi i

frekuencave të radios), GPS (sistemi i pozicionimit global) apo edhe GIS (sistemi i informimit gjeografik) mund të përdoren.

Stadi aktual i GPS (sistemit të pozicionimit global), i cili për më tepër ka edhe një kosto mjaft të ulët, ka një potencial shumë të lartë për të ndryshuar mënyrën se si bashkitë mund të grumbullojnë dhe të menaxhojnë të dhënat nga sistemet e tyre të menaxhimit të mbetjeve. Ky sistem mund të lehtësojë jo vetëm procesin e grumbullimit të të dhënave, të cilat mund të jenë më të larmishme dhe më të besueshme, por në të njëjtën kohë krijon edhe mundësinë e përdoruesve për t'i përdorur ato në mënyrë efektive.

Sistemi i gjurmimit GPS

Sistemi i gjurmimit i bazuar tek GPS mund të përdoret për të ditur në çdo kohë pozicionin e makinës së grumbullimit të mbeturinave. Për të bërë të mundur këtë, një paisje GPS instalohet në kamionin e grumbullimit dhe informacioni në lidhje me pozicionin e tij bëhet i mundur dhe transmetohet në kohë reale në zyrën qendrore ku mblidhen të dhënat. Për të transferuar këtë informacion përdoret metoda e transferimit me satelit ose metoda e transferimit përmes valeve telefonike. Përdorimi i metodës së dytë ka avantazh në krahasim me metodën e parë, pasi kushton më e lirë dhe është aktualisht e vlefshme/e gatshme, pa pasur nevojë për të instaluar ndonjë pajisje shtesë, e cila mund të jetë e shtrenjtë ose që mund të ketë probleme komplekse me mirëmbajtjen.

Dizenjimi i rrugës

Disa parametra mund të gjenerohen nga të dhënat e grumbulluara nga përdorimi i sistemit të gjurmimit, si shpejtësia e kamionit, drejtimi si dhe pozicioni i tij në kohë. Me këto informacione që na mundëson ky sistem, ne lehtësisht mund të parashikojmë kohën që i duhet një kamioni për të arritur në një vend të caktuar. Gjithashtu rruga që bën kamioni (gjurma) mund të ruhet në një database. Më tej ky informacion duke përdorur sistemin GIS, mund të përdoret për të realizuar optimizimin e internerarit që duhet të bëjë kamioni, duke identifikuar ku janë problemet, të cilat mund dhe duhet të shmangen.

Në këtë mënyrë sistemi i gjurmimit GPS mund të përdoret për të reduktuar koston e operacioneve të grumbullimit dhe transportit, duke i përdorur asetet e lëvizshme në mënyrë më efikente. Ky sistem gjithashtu i krijon mundësinë NjQV-ve ose kompanive të pastrimit për të monitoruar nga afër mënyrën dhe sjelljet e shoferit të kamionit, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe problemet potenciale të cilat po të korigjohen, mund të rrisin performancën e këtij operacioni. Kështu sistemi mund të programohet për të dhënë alarm në rast të ndryshimit të shpejtësisë apo regjimeve boshe të motorit (ndalesa të dyshimta). Duke përmirësuar sjelljen e shoferit në guidimin e kamionit, duke optimizuar rrugën dhe internerarin e lëvizjes, ky sistem mund të ndihmojë në reduktimin e lëndës djegëse dhe uljen e koston. Nga ana tjetër, duke mbajtur të dhëna të sakta dhe periodike mbi sjelljen dhe orët e punës së shoferit, jo vetëm që e bën atë dhe stafin më të përgjegjshëm gjatë orëve të punës, por në të njëjtën kohë NjQV-të/kompanitë kanë mundësi të përdorin në mënyrë më efektive këto burime që kanë në dispozicion.

Gjurmimi i kazanëve dhe llogaritja e peshës së tyre

Për të matur peshën e mbetjeve brenda një kazani, një shkallë peshoreje elektronike mund të instalohet në sistemin e ngritjes së makinës teknologjike. Kjo mund të përdoret për të peshuar kontenierin përpara se ai të zbrazet në makinë. Për të gjetur peshën e mbetjeve që ndodhen në kontenier, pesha e kontenierit bosh (që është standarte), i zbritet automatikisht peshës së kontenierit të mbushur.

Për të gjurmuar kontenierët e zbrazuar përdoret metoda e identifikimit përmes frekuencave të radios (RFID). Kështu vendosen sensorë në çdo kontenier, të cilët mund të lexohen nga lexuesi ose skanuesi që është i instaluar në kamionin e grumbullimit, në anën e sistemit ngarkues. Në momentin që kontenieri ngarkohet, në fazën e parë atij i matet pesha dhe vlera e saj rregjistrohet. Më tej ai skanohet dhe kodi i tij i transmetohet qendrës së grumbullimit të informacionit në kohë reale. Kështu duke përdorur këtë teknologji NjQV-të ose kompanitë mund të identifikojnë:

- Nëse janë grumbulluar ose jo të gjithë kontenierët dhe pesha e çdo kontenieri (për të optimizuar sistemin më vonë;
- Nëse sistemi është derë më derë, sasia e mbetjeve të prodhuara nga çdo banesë mund të identifikohet dhe kjo e dhënë mund të përdoret më vonë për të tarifuar në varësi të peshës së mbetjeve që prodhohen.

2.5 Aplikimi i skemës së monitorimit të shërbimit – Shkodra rast studimor

Në paragrafët e mëposhtëm, përmes një rasti studimor nga Bashkia Shkodër, identifikohen aktorët kryesor të përfshirë në operacionet e menaxhimit të mbetjeve në nivelin lokal dhe në detaje përshkruhen cilat janë detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre kryesore në këndvështrimin e sistemit të monitorimit të operacioneve të menaxhimit të mbetjeve.

Në kuadër të reformës së re territoriale Bashkia e Shkodrës është zgjëruar dhe tashmë përfshin disa njësi administrative si: Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Në termat e menaxhimit të mbetjeve, Bashkia e Shkodrës nga njëra anë duhet të zgjërojë kufinj të shtrirjes së shërbimit, i cili në disa nga njësitë administrative nuk është dhënë asnjëherë, dhe, nga ana tjetër, ligji organik e obligon Bashkinë e Shkodrës, sikundër edhe bashkitë e tjera, të masi dhe të monitorojë performancën e shërbimit të ofruar.

Aktualisht, Bashkia Shkodër e ka kontraktuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (grumbullimin e miksuar dhe të diferencuar, mbledhjen, transportin dhe depozitimin) për njësinë administrative Shkodër tek operatori privat, përmes një kontrate 5-vjeçare, e cila mbaron në qershor të vitit 2017. Në të njëjtën kohë, bashkia menaxhon gjithashtu kontratat ekzistuese me kompani të tjera private të pastrimit edhe në disa njësi të tjera administrative të saj.

Në figurën e mëposhtme janë prezantuar në mënyrë të përmbledhur të gjithë aktorët e përfshirë në operacionet e menaxhimit të mbetjeve për qytetin e Shkodrës.




Figura 8: Aktorët e përfshirë në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Shkodër

Nën asistencën e programit të dldp-së, Bashkia Shkodër ka ndërtuar një program të thjeshtë për monitorimin e performancës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Ky sistem synon të masë progresin e dakortësuar për çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve të përshkruar në kontratën e pastrimit, sikurse edhe përmirësimin e raportimit dhe komunikimit efektiv ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në ofrimin e këtij shërbimi.

Përveç të tjerave pritet që ky sistem monitorimi për performancën, mbasi të replikohet edhe në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Shkodër, të krijojë një sistem database-l për mbetjet dhe një sistem më të konsoliduar informacioni, mjaft i nevojshëm dhe i rëndësishëm për procesin e planifikimit.

Në diagramën e mëposhtme janë kyçur të gjithë aktorët që kanë një funksion të caktuar/rol në procesin e monitorimit të performancës për operacionet e menaxhimit të mbetjeve si dhe paraqitet mënyra e "rrjedhjes" së informacionit dhe frekuenca përkatëse e raportimit ndërmjet tyre. Kështu inspektorët e çdo rajoni (5 të tillë) duhet të raportojnë çdo ditë tek supervizorët e çdo zone (2 supervizorë), sikurse edhe në drejtorinë e shërbimeve publike. Gjithashtu inspektori i landfillit duhet të raportojë çdo ditë dhe, në fund të çdo muaji (tabelë përmbledhëse) mbi cilësinë dhe sasinë e mbetjeve të depozituara në landfillin e Bushatit. Më tej, drejtoria e punëve publike, duhet të hartojë raporte ditore, javore dhe mujore dhe të raportojë tek zëvendës kryetari i bashkisë dhe një herë në javë tek kontraktorët e shërbimit. Ndërsa këta të fundit duhet të raportojnë tek supervizorët një herë në muaj.




Figura 9: Sistemi i monitorimit të performancës (frekuenca e raportimit dhe rrjedhja e informacionit) i zbatuar në Bashkinë Shkodër

Një grup në rjetin social What's up është krijuar nga Bashkia Shkodërt për të krijuar një komunikim efektiv ndërmjet të gjithë aktorëve përgjatë procesit të monitorimit. Kështu foto dhe informacione të tjera nga terreni dërgohen dhe ndahen me njëri-tjetrin në kohë reale.

Ashtu sikundër në Bashkinë e Shkodrës, por edhe në përgjithësi në çdo NjQV, aktorët kryesorë të përfshirë në operacionet e menaxhimit të mbetjeve dhe roli i tyre në këto aktivitete janë të përshkruara në mënyrë të përmbledhur në paragrafet e mëposhtme:

2.5.1 Bashkia (Drejtoria e shërbimeve publike)

Roli kryesor i bashkisë në sektorin e menaxhimit të mbetjeve është hartimi i politikave drejt menaxhimit eficient të mbetjeve urbane (parandalimi i mbetjeve, reduktimi dhe riciklimi i tyre) duke siguruar jo vetëm për banorët e saj, por edhe për brezat e ardhshëm, një mjedis të shëndetshëm dhe të këndshëm për të jetuar.

Roli i drejtorisë së shërbimeve publike në monitorimin e performancës së shërbimit:

- Përcakton prioritetet, termat e tenderit, planin e menaxhimit të mbetjeve;
- Përcakton strategjinë e komunikimit mbi grumbullimin e mbetjeve, fshirjen dhe larjen e rrugëve;
- Përcakton buxhetet, miraton faturat, përfshirë gjobat;
- Negocion me kompaninë në rast mosmarrëveshjes;
- Raporton periodikisht (një herë në javë) te kryetari i bashkisë;
- Parashikon dhe kryen investime në infrastrukturë (kazane) dhe hap tendera te rinj, nëse është e nevojshme;
- Përcjellë shqetësimet e këshillit /kryetarit/qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar.

Objektivi kryesor i bashkisë në zbatimin e sitemit të monitorimit është të:

- Grumbullojë të dhëna për të verifikuar nëse kompania ka realizuar detyrimet kontraktuale si një bazë për hartimin e faturës;
- Grumbullojë të dhëna që lejojnë zbatimin e një sistemi të vazhdueshëm përmirësimesh dhe të masi këtë efekt.

2.5.2 Kryetarët e rajoneve dhe inspektorët

Ata duhet të kontrollojnë (vetë ose nëpërmjet inspektorëve) shërbimin e ofruar ndaj qytetarëve dhe të raportojnë tek supervizorët për:

- Verifikim i cilësisë dhe i sasisë së shërbimit: kazanë të papastruar, rrugë jo të fshira, pika grumbullimi të papastra, kazanë të dëmtuar (një herë në javë);
- Verifikim dhe pershtatje e nevojave për kazanë:
 - Kur ka shumë kazanë (ata janë bosh): propozojnë pakësimin e tyre;
 - Kur kazanët nuk mjaftojnë (kazanë të mbushur plot dhe mbetje në rrugë): propozojnë shtimin e tyre;
 - Propozojnë të zhvendosin /heqin ose të shtojnë pika grumbullimi;
- Identifikojne nevoja të veçanta: psh mbetje inerte për t'u mbledhur, ngjarje, bëjnë propozime tek supervizorët (kur nevojitet).
- Japin informacion:
 - Kompanisë + supervizorit, menjëherë për çdo mangësi në cilësi/sasi:
 - kazanë të papastruar (ID e kazanit, rrugën, ditën dhe orën e vëzhgimit);
 - rrugë jo të fshira (rrugët, ditën dhe orën e vëzhgimit);
 - kazanë të dëmtuar (ID e kazanit, rrugën, lloji i dëmtimit, ditën dhe orën e vëzhgimit);
 - kazanë që nuk lahen një herë në muaj;

- Supervisorëve një herë në muaj, përmbledhje e mangësive në cilësi/sasi;
 - o raport mujor, si bazë e raportit për bashkinë, ndëshkimet dhe gjokat e mundshme.

Kryetarët e rajoneve/administratorët mbajnë një regjistër të grumbullimit të mbeturinave + pastrimin e rrugëve (fshirje, mirëmbajtje dhe larje), i cili përmbledh:

- Kontrollat e tyre ditore;
- Komunikimet e menjëhershme të problemeve (të shkruara në formularë të tjerë);
- Pjesë të raportit mujor.

Në figurën e mëposhtme paraqitet forma e raportimit ditor që çdo inspektor, nga çdo rajon i Bashkisë Shkodër, duhet të raportojë në drejtorinë e punëve publike.

| Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave | | | | Ora e shërbimit | | 22.00 - 06.00 (turni 1) 10.00 - 13.00 (turni 2) | | | |
|---------------------------------------|-------------------------|--------|---------------------|--------------------------|----------------------------|--|-------------------------|---------------------------------------|---------|
| Raport Ditor | Zona | Rajoni | Emri i Supervisorit | Dita | Data | Ora | | | |
| | Jugore | 1 | Ilo Hajkoja | | | | | | |
| Emertimi i Rrugës | Ora e vezhgimit | Pika | Nr. i konteniereve | Frekuenca e grumbullimit | Kontenier i evaduar ose Jo | Data e larjes | Kontenier i lare ose Jo | Konteniere të demtuar ose që mungojnë | Shenime |
| 1 | Zogaj Qender | 1 | 2 | 2 here/jave | | | | | |
| | | 2 | 1 | | | | | | |
| | | 3 | 3 | | | | | | |
| | | 4 | 4 | | | | | | |
| | | 5 | 2 | | | | | | |
| 2 | Zogaj - Shiroke | 6 | 2 | 2 here/jave | | | | | |
| | | 7 | 1 | | | | | | |
| | | 8 | 2 | | | | | | |
| 3 | Rr. Ura e Bunes Shiroke | 9 | 3 | 3 here/jave | | | | | |
| | | 10 | 2 | | | | | | |
| | | 11 | 2 | | | | | | |
| | | 12 | 3 | | | | | | |
| | | 13 | 1 | | | | | | |
| | | 14 | 1 | | | | | | |
| | | 15 | 2 | | | | | | |
| | | 16 | 2 | | | | | | |
| | | 17 | 2 | | | | | | |
| | | 18 | 1 | | | | | | |
| | | 19 | 1 | | | | | | |
| 4 | Rr. Bacallekut | 20 | 3 | cdo dite | | | | | |
| | | 21 | 1 | | | | | | |
| | | 22 | 1 | | | | | | |
| | | 23 | 2 | | | | | | |
| | | 1 | 2 | | | | | | |
| 5 | Rr. Agron | 2 | 1 | cdo dite | | | | | |
| | | 1 | 1 | | | | | | |

Figura 10: Forma e raportimit për inspektorët e rajoneve

2.5.3 Supervizorët e shërbimit

Detyra e tyre kryesore është të kontrollojnë në qoftë se të gjitha operacionet e menaxhimit të mbetjeve të dakortësuara në kontratë janë zbatuar apo jo, bazuar mbi raportet e dhëna nga inspektorët. Ata duhet të menaxhojnë dhe të verifikojnë faturat, propozimet për pagesa të bëra nga kompania, sikundër edhe penaltitetet. Ato punojnë në zyrat e bashkive dhe janë nën mbikëqyrjen e departamentit të shërbimeve publike. Përshkrimi i punës për supervizorët është si më poshtë:

- Koordinimi mes kryetarëve të lagjeve/rajoneve, administratorëve, bashkisë dhe kompanisë për implementimin dhe funksionimin e mëtejshëm të sistemit:
 - Sqarimi i kompanisë për punën që do të bëjë (pikat e grumbullimit, pozicionimi i kazanëve, zonat/rrugët që do pastrohen, lahen, grafiku, etj.);
 - Verifikimin e planit të punës së kompanisë nëse kjo e fundit përmbush kërkesat (punën që duhet bërë) dhe nevojat e publikut në çdo kohë;
 - Verifikon që specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore janë përmbushur nga kompania në çdo kohë;
 - Organizon takime më të gjithë partnerët (kryetarët e rajoneve, departamentin e shërbimeve publike dhe përfaqësuesit e kompanisë) kur është e nevojshme.
- Krijimin e statistikave dhe kontrollin e sasive:
 - Grumbullon të dhënat mujore të ofruara nga kompania (statistika të dhëna nga kompania);
 - Grumbullon të dhënat e ofruara nga kryetarët e lagjeve/rajoneve dhe inspektori i lëndfillit çdo javë;
 - Verifikimi i të dhënave javore;
 - Bën kontrole fizike në zonë, takon kryetarët e rajoneve/lagjeve dhe kërkon sqarime shtesë; Frekuenca është ditore ose kur është e nevojshme.
- Përgatitja javore dhe mujore e raporteve në bashki bazuar në raportet e kryetarëve të lagjeve/rajoneve dhe statistikave përkatëse:
 - Sasitë e shërbimeve: kontrolli dhe vlefshmëria e faturimit;
 - Në mungesë të cilësisë: kazanët e pa mbledhur, rrugët e pa pastruara, pikat e grumbullimit jo të pastra, kazanët e dëmtuar të hedhur jashtë vend-depozitimit;
 - Bën propozime masash administrative (gjobash) në bashki, nëse është e nevojshme: bazuar në kontratat, raportet, dhe statistikave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve.
- Kërkon nevoja specifike tek kompania në bazë të kontratës dhe buxhetit:
 - Mbledhje e mbetjeve voluminoze;
 - Pastrimi (mbledhja e mbetjeve, pastrimi, larja) në rastet e ngjarjeve special;
 - Vendos zvoglimin ose lëvizjen e kazanëve ose propozon rritjen e numrit të tyre nëse është e nevojshme;
 - Informon menjëherë kompaninë dhe ndëshkon në rast të mungesës së cilësisë;
 - Kontrollon zgjidhjen efektive të problemeve.
- Bën propozime për adoptimin/përmirësimin e sistemit:

- Në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë partnered;
- Propozon fushata shtesë për komunikimin për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve;
- Shqyrton dhe bazuar në propozimet e kompanisë, i propozon bashkisë:
 - o Ndryshimin e orareve të grumbullimit;
 - o Të shtojë kazanë ku është e nevojshme;
 - o Zvoglimin e numrit të kazanëve ku është e nevojshme ose i zëvendëson ato;
 - o Shtimin e pikave të reja të grumbullimit;
 - o Propozon gjithë mundësitë për përmirësimin e shërbimeve, rikuperimin e mbetjeve etj.

Në figurën e mëposhtme paraqitet forma e raportimit ditore, javore dhe mujore që çdo supervisor, nga çdo zonë e Bashkisë Shkodër, duhet të raportojë në drejtorinë e punëve publike.

Raport Permbledhes Ditor

Grumbullimi i mbeturinave

| Zona Veriore | Nr. Pikave | Nr i kontenierëve | Evaduar | | Evaduar | | Te lare | | Te demtuar |
|---------------|------------|-------------------|------------|-----------|------------|------------|---------|--------|------------|
| | | | Po | ose Jo | Po | ose Jo | Po | ose Jo | |
| Rajoni 2 | 46 | 121 | 110 | 11 | | | | | |
| Rajoni 3 | 31 | 79 | 59 | 20 | | | | | |
| Rajoni 5 | 19 | 40 | 36 | 4 | | | | | |
| Totali | 96 | 240 | 205 | 35 | 85% | 15% | | | |

| Zona Jugore | Nr. Pikave | Nr i kontenierëve | Evaduar | | Evaduar | | Te lare | | Te demtuar |
|---------------|------------|-------------------|------------|-----------|------------|-----------|---------|--------|------------|
| | | | Po | ose Jo | Po | ose Jo | Po | ose Jo | |
| Rajoni 1 | 84 | 199 | 181 | 18 | | | | | |
| Rajoni 4 | 54 | 129 | 120 | 9 | | | | | |
| Rajoni 5 | 18 | 43 | 40 | 3 | | | | | |
| Totali | 156 | 371 | 341 | 30 | 92% | 8% | | | |

Permbledhje per grumbullimin

| Data | Qyteti Shkodra | Nr. Pikave | Nr i kontenierëve | Evadimi | | Larja | |
|------------|--------------------------|------------|-------------------|---------|-----------|--------|-----------|
| | | | | Pagese | Penalitet | Pagese | Penalitet |
| 20.07.2016 | E merkure (Zona Veriore) | 252 | 611 | 205 | 10,815.00 | | |
| 21.07.2016 | E Enjte (Zona Jugore) | | | 341 | 8,190.00 | | |

Pergatiti: Fatbardh Kuci (Pergjegjesi i Sherbimeve)
Alfred Luleta (Drejtori i Sherbimeve)

Raport Permbledhes Javor

Grumbullimi i mbeturinave

Periudha 12 -18 /08 /2016

| Zona Veriore | Njesia | Te Pa Evaduara | | | | | | | Shuma |
|---------------|-------------|--------------------------|--------------------------|------------------------|------------------------|-------------------------|---------------------------|-------------------------|-----------|
| | | E Premte (12/08/2016) | E Shtunë (13/08/2016) | E Diel (14/08/2016) | E Hënë (15/08/2018) | E Martë (16/08/2016) | E Merkurë (17/08/2016) | E Enjte (18/08/2016) | |
| Rajoni 2 | Copë | 20 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 | 37 | 63 |
| Rajoni 3 | Copë | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 3 | 7 |
| Rajoni 5 | Copë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| Totali | Copë | 20 | 0 | 0 | 0 | 2 | 9 | 40 | 71 |

| Zona Jugore | Njesia | Te Pa Evaduara | | | | | | | Shuma |
|---------------|-------------|--------------------------|--------------------------|------------------------|------------------------|-------------------------|---------------------------|-------------------------|-----------|
| | | E Premte (12/08/2016) | E Shtunë (13/08/2016) | E Diel (14/08/2016) | E Hënë (15/08/2018) | E Martë (16/08/2016) | E Merkurë (17/08/2016) | E Enjte (18/08/2016) | |
| Rajoni 1 | Copë | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Rajoni 4 | Copë | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 3 |
| Rajoni 5 | Copë | 0 | 4 | 8 | 1 | 2 | 0 | 2 | 17 |
| Totali | Copë | 3 | 4 | 8 | 1 | 5 | 0 | 2 | 23 |

Vlerësimi

| Java | Qyteti Shkodra | Nr. Pkave | Nr i konteniereve | Evadimi (Lekë) | | Larja (Lekë) | |
|---------------|-------------------|-----------|-------------------|----------------|-----------|--------------|-----------|
| | | | | Realizuar | Penalitet | Realizuar | Penalitet |
| 01-04/08/2016 | Zona Veriore | | | 71 | 21,939.00 | | |
| 01-04/08/2016 | Zona Jugore | | | 23 | 6,279.00 | | |

Pergatiti: Fatbardh Kuci (Pergjegjesi i Sherbimeve)

Alfred Luleta (Drejtori i Sherbimeve)

Raport mujor i permbledhur

Grumbullimi i mbeturinave

Period 01 - 18 /08 /2016

| Zona Veriore | Unit | Kazane te pambledhur | Penalizimi | Kazane te palare | Penalizimi |
|--------------|-------------|----------------------|---------------|------------------|------------|
| Rajoni 2 | cope | 99 | 30,591 | | |
| Rajoni 3 | cope | 15 | 4,635 | | |
| Rajoni 5 | cope | 1 | 309 | | |
| Total | cope | 115 | 35,535 | | |

Numri total i kazaneve te pambledhur

232

| Zona Jugore | Unit | Kazane te pambledhur | Penalizimi | Kazane te palare | Penalizimi |
|--------------|-------------|----------------------|---------------|------------------|------------|
| Rajoni 1 | cope | 24 | 6,552 | | |
| Rajoni 4 | cope | 36 | 9,828 | | |
| Rajoni 5 | cope | 57 | 15,561 | | |
| Total | cope | 117 | 31,941 | | |

Penaliteti per kompanine private

67,476 ALL

Figura 11: Raportet ditore, javore dhe mujore të supervisorëve për departamentin e punëve publike

Një muaj pas aplikimit të sistemit të monitorimit në Bashkinë e Shkodrës raportohet që:

- Koha e ofrimit të shërbimit dhe frekuencat për çdo turn janë normalizuar dhe realizohen sipas schedules së dakortësuar në orare fikse;
- Numri i kazanëve të dëmtuar është reduktuar;
- Numri i kazanëve në disa pika grumbullimi është përshtatur sipas nevojave për kazanë;
- Numri i kazanëve të pa evaduar është zvogëluar në mënyrë dramatike, shërbimi është më cilësor;
- Numri i rrugëve të pafshira dhe i sipërfaqeve të papastruara është reduktuar.

2.5.4 Supervizori/kontrolluesi në landfilld

Detyra e tij është të kontrollojë dhe të raportojë mbi aktivitetin në vend depozitim (landfilld):

- Kontrollon dhe mbledh informacione mbi sasinë e shërbimit:
 - Raporton për çdo kamion: ID e kamionit, orën, pronarin, llojin e mbetjeve (nëse është e veçantë);
 - Raporton orët e punës së makinerive (buldozerit);
 - Raporton për ndonjë ngjarje të veçante në vend-depozitim: zjarr, aksident, etj.
- Kontrollon cilësinë e mbetjeve:
 - Informon supervizorin në rast mbetjesh ose kamionësh jo në përshtatje me atë çka është përcaktuar;
- Siguron raporte javore për supervizorin.

Në figurën e mëposhtme paraqitet forma e raportimit që supervizori në vend depozitim, duhet të raportojë në drejtorinë e punëve publike çdo javë.

| EVIDENCA MUJORE E NE LANDFILD-IN E BUSHATIT | | | | | | | | | | | |
|---|---------|----------|------------|----------|------------|----------|------------|----------|------------|----------|----------|
| SH 45-02 E | | | SH 44-95 E | | SH 44-71 E | | SH 44-79 E | | SH 44-96 E | | TOT DITE |
| DATE | NR.RRUG | TON NETO | NR.RRUG | TON NETO | NR.RRUG | TON NETO | NR.RRUG | TON NETO | NR.RRUG | TON NETO | |
| 1/8/2016 | 1 | 10120 | 2 | 21680 | 0 | 0 | 2 | 14920 | 2 | 19220 | 65940 |
| 2/8/2016 | 2 | 16140 | 3 | 32720 | 1 | 11120 | 2 | 16340 | 1 | 9760 | 86080 |
| 3/8/2016 | 1 | 10000 | 1 | 11620 | 2 | 17680 | 1 | 8380 | 2 | 19660 | 67340 |
| 4/8/2016 | 1 | 11100 | 1 | 10380 | 1 | 10520 | 2 | 15980 | 1 | 10320 | 58300 |
| 5/8/2016 | 2 | 21320 | 1 | 11240 | 2 | 19440 | 1 | 8860 | 2 | 19220 | 80080 |
| 6/8/2016 | 2 | 18100 | 2 | 23840 | 1 | 10660 | 1 | 8600 | 2 | 19980 | 81180 |
| 7/8/2016 | 1 | 9580 | 3 | 30560 | 1 | 10420 | 2 | 16620 | 2 | 21120 | 88300 |
| 8/8/2016 | 2 | 21180 | 0 | 0 | 2 | 20120 | 1 | 8760 | 1 | 10520 | 60586 |
| 9/8/2016 | 2 | 20880 | 2 | 22820 | 1 | 9360 | 1 | 8540 | 3 | 30340 | 91949 |
| 10/8/2016 | 2 | 22400 | 1 | 11380 | 2 | 17680 | 3 | 23460 | 1 | 11360 | 86289 |
| 11/8/2016 | 2 | 23240 | 1 | 11120 | 1 | 8960 | 1 | 9500 | 1 | 10540 | 63366 |
| 12/8/2016 | 1 | 9660 | 1 | 11660 | 2 | 16120 | 1 | 8020 | 3 | 28240 | 73708 |
| 13/8/2016 | 2 | 19700 | 3 | 21820 | 3 | 26220 | 3 | 20980 | 1 | 10300 | 99032 |
| 14/8/2016 | 1 | 9260 | 2 | 20220 | 0 | 0 | 1 | 8160 | 2 | 20700 | 58340 |
| 15/8/2016 | 2 | 22060 | 1 | 8800 | 2 | 17880 | 1 | 8340 | 1 | 10720 | 67800 |
| 16/8/2016 | 2 | 17880 | 2 | 20040 | 2 | 13700 | 1 | 10480 | 2 | 22220 | 84320 |
| 17/8/2016 | 2 | 20500 | 1 | 10780 | 2 | 18460 | 2 | 17520 | 2 | 20880 | 88140 |
| 18/8/2016 | 2 | 21440 | 2 | 24460 | 3 | 28040 | 0 | 0 | 2 | 21020 | 94690 |
| 19/8/2016 | 1 | 8840 | 2 | 26520 | 2 | 17200 | 1 | 8660 | 1 | 10800 | 72020 |
| 20/8/2016 | 2 | 19200 | 2 | 23460 | 2 | 18140 | 1 | 10060 | 1 | 10640 | 81500 |
| 21/8/2016 | 3 | 33020 | 1 | 11040 | 1 | 8920 | 2 | 16740 | 3 | 32080 | 101800 |
| 22/8/2016 | 3 | 33020 | 2 | 24100 | 0 | 0 | 1 | 7320 | 2 | 21000 | 85440 |
| 23/8/2016 | 3 | 29900 | 2 | 23000 | 2 | 17220 | 2 | 19960 | 1 | 10560 | 100640 |
| 24/8/2016 | 1 | 11500 | 2 | 25360 | 1 | 9960 | 1 | 8680 | 3 | 30900 | 86400 |
| 25/8/2016 | 2 | 17380 | 2 | 23780 | 2 | 19160 | 0 | 0 | 2 | 20760 | 81080 |
| 26/8/2016 | 2 | 16480 | 2 | 17520 | 1 | 10900 | 0 | 0 | 2 | 17060 | 61960 |
| 27/8/2016 | 1 | 9120 | 1 | 7780 | 2 | 18560 | 1 | 7720 | 2 | 20100 | 63280 |
| 28/8/2016 | | | | | | | | | | | |
| 29/8/2016 | | | | | | | | | | | |
| 30/8/2016 | | | | | | | | | | | |
| 31/8/2016 | | | | | | | | | | | |
| | 48 | 483020 | 45 | 487700 | 41 | 376440 | 35 | 292600 | 48 | 490020 | 2129560 |
| Monitoruesi Agron Kraja | | | | | | | | | | | |

Figura12: Sasia ditore e mbeturinave të depozituara në landfillin e Bushatit

2.5.5 Kompania që ofron shërbimin (kontraktori)

Në kontekstin e raportimit, kontraktuesi duhet të mbajë statistika ditore, për pikat kryesore të paraqitura si më poshtë dhe t'i raportojë ato çdo muaj, në formë elektronike apo në letër, tek supervizori.

- Sasinë ditore të mbetjeve të grumbulluara dhe depozituara në landfill/venddepozitim;
- Numrin e kazanëve të pastruar;
- Orët e sakta të grumbullimit: kohën e saktë të nisjes së kamionëve, kohën e zbrasjes në venddepozitim dhe kohën e kthimit në garazh;
- Kilometrat ditore të çdo kamioni;
- Numrin ditor dhe intenerarin e lëvizjes së kamionëve;
- Listën ditore të pastrimit dhe larjes së rrugëve;
- Oraret ditore të larjes dhe fshirjes manulae/mekanike;
- Lista e punonjësve dhe oraret ditore të punës;
- Inventarin mujor të kazanëve, nga rruga në rrugë dhe gjendjen fizike të tyre;
- Zhvendosjen, mbajtjen ose humbjen e kazanëve:

- Kazanët e larë;
- Listën e kazanëve me probleme (rrugën, numrin e kazanit), riparimet specifike, datën etj.;
- Sasinë e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluar/përpunuar nga qendra(t) e grumbullimit;
- Marrjen e komenteve/reagim ndaj kërkesave të kryetarëve të lagjeve/rajoneve ose supervisorit rreth mungesës së cilësisë apo sasisë së grumbulluar.

Në figurën e mëposhtme paraqitet forma e raportimit që kontraktori duhet të raportojë tek supervisorin dhe në drejtorinë e punëve publike çdo muaj.

| Date | Daily waste disposed in landfill (ton) | No of containers collected | No of containers washed | No of containers repaired | Total no of containers | Street surface mechanical sweeping | Street surface manual sweeping | Street surface washed |
|----------|--|----------------------------|-------------------------|---------------------------|------------------------|------------------------------------|--------------------------------|-----------------------|
| 8/1/2016 | | | | | | | | |
| 8/2/2016 | | | | | | | | |
| 8/3/2016 | | | | | | | | |
| 8/4/2016 | | | | | | | | |
| 8/5/2016 | | | | | | | | |
| 8/6/2016 | | | | | | | | |
| 8/7/2016 | | | | | | | | |

| Data | ID of the vehicle | Time of departure of the trucks | Time of unloading on the landfill | Time of coming back to the garage | Daily km of each truck |
|----------|-------------------|---------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------|
| 8/1/2016 | | | | | |
| 8/2/2016 | | | | | |
| 8/3/2016 | | | | | |
| 8/4/2016 | | | | | |
| 8/5/2016 | | | | | |
| 8/6/2016 | | | | | |
| 8/7/2016 | | | | | |

Figure 13: Raportet dhe informacionet e raportuara nga kontraktori

2.5.6 Aplikimi i sanksioneve

NjQV-të duhet fillimisht të përfshijnë në kontratat e shërbimit dhe më pas të zbatojnë me rigorozitet sanksione dhe penalitetet për të siguruar që kontraktuesi është duke përmbushur me rigorozitet të gjitha operacionet e menaxhimit të mbetjeve sipas kushteve të dakortësuara në kontratë.

❖ Rasti kur shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet nga një operator privat

Në paragrafët e mëposhtëm jepen shembuj të sanksioneve të ndryshme të hartuara dhe të vendosura në kontratën e shërbimit që Bashkia Shkodër ka me operatorin privat.

Penalltia 1 –për kontenierët e dëmtuar

- **Qëllimi:** të shmangen kontenierët e dëmtuar, të cilët reduktojnë efikasitetin në grumbullim: nuk ka kontenierë të dëmtuar në rrugë.

- **Përgjegjësia:** Kompania duhet të identifikojë dhe të riparojë të gjithë kontenierët e dëmtuar. Gjithashtu kompania duhet të lajë kontenierët çdo muaj.
- **Kontrolli:** Eshtë detyra e kryetarëve të rajoneve dhe inspektorëve të identifikojnë dhe të raportojnë tek kompania numrin e kontenierëve të dëmtuar, të cilët duhet të zëvendësohen dhe të riparohen. Gjithashtu duhen identifikuar kontenierët e palarë. Kompania ka 5 ditë kohë për të riparuar kontenierët. Kompania i jep supervizorëve listën e kontenierëve që janë riparuar dhe që janë larë përmes raportit mujor.
- **Kriteri:** Nuk duhet të lejohet që numri i kontenierëve të dëmtuar të jetë më shumë se 3% e totalit të numrit të kontenierëve (8 copë) përgjatë një jave raportim.
- **Penalltia:** Reduktimi me 5 % i çmimit të grumbullimit të një kontenieri për të gjithë kontenierët e dëmtuar për të gjithë periudhën që ata nuk janë riparuar.

Penalltia 2 – për kontenierët që nuk janë evaduar

- **Qëllimi:** Të sigurojë një cilësi të mirë të grumbullimit, të detyrojë kompaninë për t'u dhënë zgjidhje alternative në raste të problemeve (mekanike, personale, etj.).
- **Përgjegjësia:** Kompania duhet të grumbullojë çdo kontenier sipas frekuencës së kërkuar.
- **Kontrolli:** Kryetarët e rajoneve/inspektorët duhet të kontrollojnë dhe të raportojnë në bashki, së bashku me informacionin e marrë nga supervizorët, në qoftë se grumbullimi nuk është bërë, duke përcaktuar vendin, numrin e kontenierit, datën dhe orën e mbikëqyrjes.
- **Kriteri: Penallti** në qoftë se më tepër se 10 kontenierë janë evidentuar si të pa grumbulluar në një muaj.
- **Penalltia:** reduktimi me 150 % i çmimit të grumbullimit të një kontenieri për të gjithë kontenierët e pagrumbulluar.

Penalltia 3 – për kontenierët e pazëvendësuar

- **Qëllimi:** Të sigurohet që të gjithë kontenierët e dëmtuar, të cilët nuk mund të riparohen, janë zëvendësuar nga kompania, për të garantuar prezencën e numrit të kërkuar të kontenierëve në rrugë, ashtu siç përcaktohet nga bashkia.
- **Përgjegjësia:** Kompania duhet të zëvendësojë kontenierët që nuk riparohen.
- **Kontrolli:** Kryetarët e rajoneve/inspektorët duhet të raportojnë në bashki dhe tek kompania përmes informacionit të supervizorëve në qoftë se kontenierët mungojnë, duke treguar vendin, numrin e kontenierit, datën dhe orën e mbikëqyrjes.
- **Kriteri:** Penallti për çdo kontenier të munguar në muaj.
- **Penallti:** Reduktimi me 150 % i çmimit të grumbullimit të një kontenieri për të gjithë kontenierët e pagrumbulluar.

Penalltia 4 – për rrugët e pafshira

- **Qëllimi:** Të sigurojë një cilësi të lartë të fshirjes së rrugëve, të detyrojë kompaninë për të dhënë zgjidhje alternative në raste të problemeve (mekanike, personale, etj.).
- **Përgjegjësia:** Kompania duhet të fshijë çdo rrugë të kërkuar sipas programit dhe frekuencës të dakortësuar me bashkinë. Gjithashtu ajo duhet të gjejë zgjidhje alternative në qoftë se nevojitet,

- **Kontrolli:** Kryetarët e rajoneve/inspektorët do të kontrollojnë dhe raportojnë në qoftë se fshirja është kryer apo jo.
- **Kriteri:** Penaliti në qoftë se më tepër se 2% e sipërfaqes së rrugëve nuk janë fshirë përgjatë një muaji. Gjithashtu penaliti në qoftë se makineritë e fshirjes nuk janë funksionale më tepër se 10 ditë në muaj.
- **Penalltia:** Reduktim me 150 % të çmimit të fshirjes për të gjitha sipërfaqet e rrugëve të pashërbyera.

Penalltia 5 – për depozitim të mbetjeve në vendin e gabuar

- **Qëllimi:** Për të shmangur në mënyrë të rreptë faktin që kompania mund të depozitojë mbetjet në vende të pa përcaktuara nga bashkia, pa pasur ndonjë leje apo autorizim nga kjo e fundit.
- **Përgjegjësia:** Kompania duhet t'i depozitojë mbetjet aty ku është kërkuar (landfilli i Bushatit)
- **Kontrolli:** Kryetarët e rajoneve/inspektorët/supervizorët ose çdo zyrtar tjetër i departamentit të punëve publike evidenton dhe raporton vend depozitimet ilegale të mbeturinave.
- **Kriteri:** Penaliti për çdo shkarkim të kamionëve të kompanisë në vende të pa autorizuar.
- **Penaliti:** Reduktimi me 5 % i çmimit total të muajit për grumbullimin e mbetjeve për çdo kamion të evidentuar që shkarkon mbetjet në vende të pa autorizuar. Gjithashtu kompania është e obliguar me kostot e saja, t'i grumbullojë sërish mbetjet e depozituara në vende ilegale dhe t'i shkarkojë ato në ato vende ku është caktuar nga bashkia.

Penalltia 6 – për mos dhënien ose raportimin e gabuar

- **Qëllimi:** Të sigurojë që kompania jep çdo muaj raportin e kërkuar dhe të dhënat statistikore, të cilat që të gjitha të korrespondojnë me realitetin.
- **Përgjegjësia:** Kompania duhet të raportojë çdo muaj deri në datën 15 të muajt tjetër, të dhënat e nevojshme, reale dhe të sakta tek supervizori.
- **Kontrolli:** Supervizori duhet të kontrollojë datën e marrjes së raportimit si dhe duhet të shikojë dhe kontrollojë sa reale janë të dhënat me ndihmën e raporteve që vijnë nga kryetarët e rajoneve/inspektorëve dhe inspektorit të landfillit.
- **Kriteri:** Penaliti akumulativ për çdo ditë/javë vonesë. Penaliti e dyfishtë në qoftë se të dhënat janë gabim, sikundër vuajtje e të gjitha konsekuencave të marra në konsideratë në raste të tilla nga ligji.
- **Penaliti:** Reduktim me 2 %, më tej 4 % pas javës tjetër e kështu me rradhë të faturës së muajt në muajin pasardhës.

❖ Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet nga ndërmarrjet bashkiake

Në rastet kur shërbimi ofrohet nga ndërmarrjet bashkiake, dështimi për të arritur minimumin e standartit të shërbimit të ofruar mund të jetë subjekt, i vërejtjeve, penalltive deri në largimin nga puna të personave përgjegjës:

Penalltia 1 – Mos grumbullimi i kontenerëve pa pasur ndonjë arsye të qartë

- **Qëllimi:** Të sigurojë një mbulim maksimal me shërbim me standarte të larta.

- **Përgjegjësia:** Ndërmarrja bashkiake duhet të grumbullojë të gjithë kontenierët sipas frekuencave të caktuara.
- **Kontrolli:** Inspektorët bashkiakë duhet të kontrollojnë dhe raportojnë në qoftë se grumbullimi nuk është bërë siç duhet, duke përcaktuar vendin, numrin e kontenierit, datën dhe orën e mbikëqyrjes.
- **Kriteri:** Penallti në qoftëse më tepër se 10 % e kontenierëve raportohen si të pa mbledhur në muaj.
- **Penallti:** Sanksionet mund të shoqërohen me vërejtje në punë dhe të mund të ndiqen nga të tjera konsekuenca, siç përcaktohen në Kodin e Punës.

Penallti 2 – Shërbimi i grumbullimit dhe transportit nuk kryhet sepse makinat dhe kamionët nuk operojnë si pasojë e difekteve apo mungesës së lëndës djegëse

- **Qëllimi:** Të sigurohet një shërbim cilësor i grumbullimit dhe transportit.
- **Përgjegjësia:** Drejtorja mekanike (shefi i sektorit) duhet të sigurojë që të gjitha makinave i bëhen shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimet sipas skedave teknike të makinave të miratuara më parë.
- **Kontrolli:** Inspektorët e bashkisë duhet të kontrollojnë dhe të raportojnë, në qoftë se ndonjë nga makinat nuk është në operim sipas orarit dhe frekuencës së përcaktuar, duke treguar rrugën ose zonën ku shërbimi nuk është ofruar, targën e makinës, datën dhe orën e vëzhgimit.
- **Kriteri:** Penallti për çdo makinë që nuk është në gjendje pune.
- **Penallti:** Sanksionet si për mekanikët ashtu edhe për shoferët mund të shoqërohen me vërejtje në punë dhe të mund të ndiqen nga të tjera konsekuenca siç përcaktohen në Kodin e Punës.

Penallti 3 – Rrugët nuk janë të fshira dhe të lara siç duhet, pasi stafi nuk ka plotësuar orët e punës

- **Qëllimi:** Të sigurojë që të gjitha rrugët e asfaltuara dhe sheshet marrin shërbim cilësor dhe janë të pastra (të fshira dhe të lara).
- **Përgjegjësia:** Sektori i fshesëtarëve (kryetari i sektorit) është përgjegjës në qoftë se shërbimet e fshirjes dhe larjes e mirëmbajtjes së rrugëve dhe shesheve nuk bëhen sipas frekuencave të caktuara.
- **Kontrolli:** Inspektorët e bashkisë duhet të kontrollojnë dhe të raportojnë në qoftë se fshirja dhe larja nuk realizohen, duke treguar rrugët apo sheshet që nuk kanë marrë shërbim, datën dhe orën e mbikëqyrjes.
- **Kriteri:** Penallti në qoftë se më tepër se 2% e sipërfaqeve të rrugëve nuk janë fshirë apo larë në muaj ose në qoftë se mjetet automatike të fshirjes apo larjes së rrugëve qendrojnë më tepër se 10 ditë jashtë funksionimit për difekte të ndryshme.
- **Penallti:** Sanksionet si për stafin (fshesëtarët) ashtu edhe për shoferët (makinat e larjes ose fshirjes) mund të shoqërohen me vërejtje në punë dhe të mund të ndiqen nga të tjera konsekuenca, siç përcaktohen në Kodin e Punës.

2.6 Pikat kryesore për t'u mbajtur mend

Monitorim efektiv dhe një vlerësim i detajuar i çdo operacioni të këtij shërbimi do ti ndihmonte NjQV-të për:

- Të matur progresin e çdo operacioni më vete në menaxhimin e mbetjeve kundrejt objektivave dhe targeteve të dakortësuara në kontratën e shërbimit;
- Të matur efektivitetin e paisjeve dhe stafit të përdorur në çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve;
- Të hartuar dhe adresuar masa korrektuese dhe rregullatore për të përmirësuar shërbimin bazuar mbi informacionin e mbledhur përmes monitorimit;
- Të vlerësuar shpenzimet dhe për të kontrolluar kostot e çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve, për t'u siguruar që buxheti ekzistues është i shpërndarë në mënyrën e duhur dhe është i mjaftueshëm;
- Të vlerësuar sjelljen e përdoruesve si dhe matur kënaqësinë e konsumatorit;
- Të planifikuar më mirë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen dhe vlerësuar mundësitë dhe potencialet e zgjerimit dhe riplanifikimit të shërbimit.

Sistemi i monitorimit të performancës është një cikl i mbyllur dhe i vazhdueshëm përmirësimesh, i cili përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

- Përcaktimi i qëllimit dhe objektivave të monitorimit (objektivat SMART);
- Identifikimi i të gjithë aktorëve të përfshirë dhe detajimi i përgjegjësive dhe rolit që ata kanë për të luajtur në këtë sistem (përcaktimi i rrjedhjes së informacionit dhe frekuencave e përbërjes së raportimit);
- Zhvillimi i skemës së monitorimit, e cila nënkupton proceset e grumbullimit të të dhënave, analizimit të tyre, identifikimit të mundësive për të përmirësuar performancën si dhe hartimi i masave korrektuese.

Sistemi i gjurmimit që përdor GPS, i aplikuar tek operacionet e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave mund të sjellë optimizimin e kostos së këtij operacioni.

Në të dyja rastet, si kur shërbimi ofrohet nga ndërmarrjet bashkiake, ashtu edhe kur ai kontraktohet tek një operator privat NjQV, duhet të hartojnë, të përfshijnë në kontratë dhe të zbatojnë sanksione për të siguruar që ofruesit e shërbimit janë duke plotësuar të gjitha objektivat që ka bashkia për të ofruar një shërbim cilësor dhe një mjedis të shëndetshëm për të gjithë banorët e saj.

KAPITULLI 3: SISTEMI I BENCHMARK-UT

3.1. Hyrje në sistemin e benchmark-ut

Në kapitullin e mëparshëm është paraqitur metodologjia sesi bashkitë mund të monitorojnë shërbimet që ato ofrojnë si dhe performancën e tyre, bazuar në sisteme të ndryshme të monitorimit. Sistemi i benchmark-ut synon zgjërimitin e kësaj praktike në nivel kombëtar, për të krahasuar bashkitë ndërmjet tyre, pasi ekziston një ndryshueshmëri e lartë në aspektin e ofrimit të shërbimeve, cilësinë dhe koston e tyre, në vend. Një sistem benchmark-u mund të ndihmojë në identifikimin dhe matjen e nivelit minimal të shërbimit në vend dhe gjithashtu identifikon rastet më të mira, për të nxitur një konkurrencë pozitive.

Sistemi i benchmark-ut është një set i dakortësuar indikatorësh, të cilët përdoren për të matur dhe për të raportuar periodikisht aspekte të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve. Sistemet e benchmarkut mund të hartohen si në nivelin kombëtar, në nivelin rajonal dhe atë lokal.

Indikatorët e përdorur nga sistemi benchmark-ut në nivelin kombëtar duhet të përshkruajnë situatën ekzistuese të vendit në nivelin qendror duke krijuar mundësinë për të realizuar krahasimin e tij me vendet e rajonit, sikurse dhe të masin performancën e vendit kundrejt një seti indikatorësh ndërkombëtar, sic mund të jenë EU target në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të përcaktuara nga Direktiva 2008/98/EC për mbetjet (Direktiva Kuadër e Mbetjeve).

Seti i indikatorëve të benchmark-ut në nivel kombëtar përshkruajnë situatën mesatare të menaxhimit të mbetjeve në vend, ndërkohë që në praktike vlerat e këtyre indikatorëve variojnë shumë nga një bashki në tjetrën.

Përsa kohë që autoritetet lokale janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, ekziston një arësye legjitime për të ndërtuar sistemin e benchmark-ut në nivelin lokal, apo ndërmjet rajoneve të ndryshme brenda një bashkie gjithashtu. Autoritetet lokale shpesh herë përballen me buxhete të limituara për të zhvilluar infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve. Sistemi i benchmark-ut i hartuar dhe i dakortësuar në nivel lokal do t'i japi informacionin e duhur NjQV për të marrë vendim dhe caktuar prioritetet për përmirësimin e shërbimit në kushtet aktuale që ato ndodhen (me buxhete të limituara) duke i krijuar gjithashtu mundësinë e monitorimit për të bërë të mundur ndryshimet në kohë.

Hartimi i sistemit të benchmark-ut në nivelin lokal për menaxhimin e mbetjeve do t'i ndihmojë NjQV për të pasur një prespektivë të pavarur sesi është duke performuar sistemi i menaxhimit të mbetjeve në bashkitë e tjera. Ai qartësisht përcakton aspekte specifike dhe oportunitetet për të prioritarizuar përmirësimet, duke përcaktuar pritshmëritë e performancës dhe ndryshimet që mund të vijnë nga monitorimi në nivel lokal. Përfundimisht ky sistem ndihmon në menaxhimin e mbetjeve të ngurta në një mënyrë sociale të pranueshme, ekonomikisht të qendrueshëm dhe në harmoni të plotë me mjedisin.

Procesi i hartimit të një sistemi benchmark duhet të jetë një proces me pjesëmarrjen e grupeve të interesit (përfaqësues nga ministritë e linjës, nga NjQV, "service providers", përfaqësues nga shoqëria civile si dhe ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë). Ai duhet bazuar tërësisht mbi gjendjen aktuale të nivelit të shërbimit që ofrohet sot në NjQV si dhe duhet udhëhequr/drejtuar nga principet dhe politikat e hartuara në nivel kombëtar. Në figurën e mëposhtme paraqiten fazat kryesore të tij.




Figura 14: Hapat kryesor në hartimin dhe zbatimin e sistemit të benchmark-ut

Disa nga arësyet kryesore të hartimit një sistemi benchmark-u janë përmbledhur si më poshtë:

- Të bëjë të mundur për çdo NjQV të gjykojë performancën e vet në lidhje me ofrimin e shërbimit të MMN;
- Të japë informacionin e nevojshëm për autoritetet vendim-marrëse mbi prioritetet për përmirësimin e shërbimit të MMN në kushtet aktuale me fonde të kufizuara në dispozicion;
- Të bëjë të mundur identifikimin e pikave të forta (rrethanave lokale) mbi bazën e të cilave mund të ndërtohet më tej si dhe evidentimin e pikave të dobëta të cilat duhen trajtuar me kujdes;
- Të monitorojë ndryshimet në cilësinë e shërbimit të MMN me kalimin e kohës.

3.1.1 Përse standardet dhe sistemi i benchmark-ut janë të rëndësishme për NjQV-të?

Sistemi i benchmark-ut është një praktikë e njohur dhe një ushtrim konkret për të përcaktuar gjendjen ekzistuese të një shërbimi për menaxhimin e mbetjeve në NjQV-të, sikurse edhe për të evidentuar praktikën më të mirë në menaxhimin e mbetjeve dhe për të identifikuar potencialet dhe oportunitetet për të përmirësuar performancën e aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve.

Çfarë në të vërtetë do të nënkuptojmë me “praktika të mirë” në menaxhimin e mbetjeve?

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, ofrohet në pothuaj të gjitha zonat urbane të vendit, por nuk mund të themi të njëjtën gjë për zonat rurale (gjithësesi edhe kur ofrohet ai nuk mbulon gjithë territorin). Sistemi i grumbullimit që zbatohet në pothuaj të gjitha NjQV, është shërbim grumbullimi kolektiv me kontenerë 1.1 m³ të vendosur në akset kryesore të rrugëve. Nuk ekzistojnë sisteme të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, dhe ndarja e mbetjeve në burim nuk është ende një praktikë e zbatuar. Sektori informal kryen aktivitetin e tij në pikat e grumbullimit dhe në vend depozitime, duke tentuar të tërheqë materialet e riciklueshme që mundet. Industria e riciklimit është prezente në vend, por punon me sasi të vogla të materialeve të riciklueshme, pra jo

me kapacitet optimal. Në shumicën e rasteve mbetjet depozitohen në fusha të hapura, të cilat operojnë në mungesë të plotë të çdo lloj standarti higjieno-sanitar. Mbetjet vetëm depozitohen në to dhe nuk i nënshtrohen asnjë trajtimi. Përjashtim bëjnë qytetet e Tiranës, Shkodrës dhe Sarandës të cilët kanë në dispozicion landfillde.

Megjithatë, duke matur nivelin e performancës për çdo operacion në zinxhirin e menaxhimit të mbetjeve si dhe duke matur rezultatet e çdo operacioni përbërës të këtij shërbimit, në mënyrë indirekte, ne mund të reflektojmë mbi kapacitetet institucionale, infrastrukturën e mbetjeve, performancën financiare dhe të tjera parametra për NJQV. Kështu duke prezantuar indikatorët përbërës të sistemit të benchmark-ut, do të na krijojë ne mundësinë jo vetëm që të prezantojmë situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, por gjithashtu do të na lejojë të bëjmë një krahasim të këtyre indikatorëve ndërmjet NJQV.

3.1.2 Si do t'i ndihmojë ky kapitull NjQV-të për të përmirësuar praktikat e menaxhimit të mbetjeve?

Informacioni dhe njohuritë e shpjeguara në këtë kapitull do të mund t'i ndihmojnë NjQV për të:

- Përshkruar situatën ekzistuese dhe të të gjitha operacionet e menaxhimit të mbetjeve në territorin e tyre në një mënyrë të sintetizuar;
- Të krahasojnë gjendjen e tyre ekzistuese me indikatorët e sistemit të benchmark-ut, duke përcaktuar prioritetet dhe operacionet që kanë potencial për të përmirësuar performancën e sistemit të menaxhimit të mbetjeve;
- Të krahasojnë gjendjen e tyre ekzistuese me të tjera NjQV, për të identifikuar pikat e tyre të dobëta, sikurse edhe praktikat e mira nga njësitë e tjera. Kështu praktikat e mira në menaxhimin e mbetjeve do të gjejnë terrenin e duhur për t'u përhapur, duke qenë subjekt i replikimit edhe nëpër NjQV të tjera.

3.2 Indikatorët e performances të përdorur nga sistemi i benchmark-ut

Hapi i parë në hartimin e indikatorëve të performancës është përcaktimi i aspekteve të ndryshme të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, të cilat më vonë do të jenë subjekt i vlerësimit përmes indikatorëve. Zakonisht aspektet e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ofruara në çdo NjQV që do të vlerësohen janë përmbledhur si më poshtë:

- (i) Infrastruktura ekzistuese;
- (ii) Cilësia e shërbimit;
- (iii) Qëndrueshmëria financiare;
- (iv) Qëndrueshmëria mjedisore;
- (v) Aspekte institucionale.

Më tej për çdo aspekt të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të përmendur më sipër zhvillohen indikatorët që masin performancën e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjithë indikatorët që janë përdorur për të ndërtuar sistemin e benchmark-ut. Disa prej tyre, të cilat masin performancën e shërbimit, janë përdorur

gjithashtu edhe përgjatë fazës së planifikimit. Mënyra sesi ato llogariten është paraqitur e detajuar në kapitullin e parë

| A Informacion i përgjithshëm | | |
|---|---|--|
| A1 | Type of service provision | <ul style="list-style-type: none"> ▪ E ofrojnë shërbimin vetë ▪ E kontraktjnë shërbimin ▪ E ofrojnë shërbimin së bashku |
| A2 | Population | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i banorëve ▪ Numri i banorëve sezonal |
| A3 | Sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara | <ul style="list-style-type: none"> ▪ kg mbetje/banorë/ditë ▪ ton mbetje/vit |
| A4 | Përbërja e mbetjeve | <ul style="list-style-type: none"> ▪ % e të riciklueshmeve të thata (letër, karton, plastikë etj.) ▪ % e të riciklueshmeve të njoma (bio-organike) ▪ % e atyre që mbesin |
| A5 | Parametra të tjerë | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fuqia kalorifike e mbetjeve ▪ % e lagështisë tek mbetjet ▪ Densiteti i mbetjeve |
| B Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese | | |
| B1 | Shpërndarja e kontenierëve | $B1 = \frac{\text{Nr. i konteniereve}}{\text{km}^2}$ |
| B2 | Numri i banorëve që shërbehet nga një makinë për grumbullim dhe transport mbeturinash | $B2 = \frac{\text{Nr. i banoreve}}{\text{Nr i kamioneve}}$ |
| B3 | Numri i banorëve që shërbehet nga një kontenier që mbledh mbeturinat të miksuara | $B3 = \frac{\text{Nr. i banorëve}}{\text{Nr. i konteniereve te miksuara}}$ |
| B4 | Numri i banorëve që shërbehet nga një kontenier që mbledh mbeturinat të diferencuara | $B4 = \frac{\text{Nr. i banorëve}}{\text{Nr. i kontenierëve të diferencuara}}$ |
| C Vlerësimi i cilësisë së shërbimit | | |
| C1 | Efiçenca ne grumbullimin e mbetjeve | $C1 = \frac{\text{sasia e mbetjeve të grumbulluara } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{sasia e mbetjeve të prodhuara } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$ |
| C2 | Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve dhe fshirjes së rrugëve | <p>C2.1 Prezencë e mbetjeve të akumuluar përrreth kontenierëve/PGM.</p> <p>C2.2 Prezenca e mbeturinave në rrugët kryesore të qytetit dhe në vendet më të populluara.</p> <p>C2.3 Prezenca e mbetjeve të akumuluar/vend depozitime ilegale/djegje mbeturinash në periferi.</p> <p>C2.4 Zbatim i drejtë i kontrollit dhe i supervizimit.</p> <p>C2.5 Përdorimi i mjeteve personale mbrojtëse dhe zbatimi i protokolleve.</p> |

| | | |
|--|--|--|
| C3 | Efiçenca në adresimin e ankesave të klienteve | $C3 = \frac{\text{Nr. i ankesave të adresuara (24 h)}}{\text{Nr. i ankesave (24h)}} \times 100$ |
| D Vlerësimi i qëndrueshmërisë mjedisore | | |
| D1 | Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve | $D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumb. veçmas}}{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluara}} \times 100$ |
| D2 | Shkalla e trajtimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin | $D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të trajtuara sipas legjislacionit}}{\text{sasia e mbetjeve të grumbulluara}} \times 100$ |
| E Vlerësimi i qëndrueshmërisë ekonomike | | |
| E1 | Shkalla e rikuperimi kostos | $E1 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga MM (\frac{lek}{vit})}}{\text{Kosto vjetore operative (\frac{lek}{vit})}} \times 100$ |
| E2 | Efiçenca në mbledhjen e tarifave (për cdo përfitues shërbimi) | $E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga MM (\frac{lek}{vit})}}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara (\frac{lek}{vit})}} \times 100$ |
| E3 | Kostot njësi të shërbimit | $E3 = \frac{\text{Kosto totale e shërbimit (lek)}}{\text{Sasinë e mbetjeve (ton)}}$ $E3 = \frac{\text{Kosto totale e shërbimit (\frac{Lek}{vit})}}{\text{Banorë}}$ |
| F Vlerësimi i aspekteve institucionale | | |
| F1 | Shkalla e koherencës së institucioneve lokale | F1.1 Struktura organizative F1.2 Kapacitetet institucionale F1.3 Plani lokal i MMN F1.4 Disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave për MMN F1.5 Kontrolli, menaxhimi dhe supervizimi i shërbimit F1.6 Bashkëveprimi ndërkomunal |

3.3 Matja dhe vlerësimi i performancës

Informacioni i mbledhur nga sistemi i benchmark-ing do të ndihmojë bashkitë në zhvillimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve, si dhe në përcaktimin e praktikave më të mira për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacione dhe të dhëna të besueshme si dhe për monitorim të vazhdueshëm. Monitorimi ofron mundësinë për të bërë një vlerësim të drejtë të performancës së ofrimit të shërbimeve në secilën bashki si dhe për të vendosur objektiva realiste, duke marrë parasysh kapacitetet dhe mundësitë lokale të tyre.

Sistemi i Benchmark-ing mund të ndihmojë gjithashtu bashkitë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për mbetjet urbane. Mungesa e të dhënave është shpesh një normë për NJQV-të në menaxhimin e mbetjeve urbane, gjë që në praktikë shpesh herë kthehet në një pengesë për të planifikuar dhe ndërmarrë vendime të zbatueshme ose shpesh herë i drejton vendim-marrësit në një drejtim të gabuar.

Brenda një sistemi benchmark-u, analizimi i treguesve të performancës mund të ndihmojnë secilën bashki në:

- Hartimin e prioriteteve për bashkinë;
- Identifikimin brenda çdo operacioni të MMU, cilat janë mundësitë për përmirësim të mëtejshëm;
- Zhvillimin e objektivave SMART për të përmirësuar procesin e planifikimit;
- Në njohjen e kostos së plotë të çdo operacioni të menaxhimit të mbeturinave;
- Në llogaritjen/ndryshimin e buxhetit të kontratës;
- Rritjen e efikasitetit të secilit operacion të MMU;
- Hartimin e politikave të duhura që mund të jetë të zbatueshme dhe
- në propozimin e ndonjë kërkesë ligjore.

Gjithashtu përmes sistemit të benchmark-ut çdo bashki mund të analizojë performancën e ofrimit të shërbimit edhe në pjesë të ndryshme të territorit të saj, duke evidentuar praktikat e mira si dhe ndërhyrjet e nevojshme apo përmirësimin e cilësisë së shërbimit në ato territore ku ai është modest apo nuk ofrohet. Analiza e treguesëve financiarë do ta lejojë bashkinë të kuptojë në këtë rast se ç'pjesë e kostos mbulohet nga cilët përfitues të shërbimit (sa % mbulojnë qytetarët, sa % bizneset, sa % institucionet publike...etj) si dhe kush paguan për kë, sa duhet të subvencionojë bashkia, etj.?

Në tabelën e mëposhtme paraqitet një sintezë e analizës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër si dhe krahasimi i performancës së shërbimit në rajone të ndryshme të kësaj bashkie.

| | Treguesit | Shkodra | Ana e Malit | Berdica | Guri i Zi | Postribe | Rrethinat | Dajc | Velipoja |
|---------------------------------------|---|----------|-------------|---------|-----------|----------|-----------|---------|----------|
| Cilësia e shërbimit | C1 Mbulimi me shërbim | 90% | 73% | 69% | 53% | 55% | 68% | 73% | 70% |
| | C2 Pastertia e bashkise | 82% | 32% | 49% | 32% | 32% | 32% | 49% | 49% |
| | C3 Perceptimi publik | unknown | unknown | unknown | unknown | unknown | unknown | unknown | unknown |
| Qëndrueshmëria mjedisore | D1 Shkalla e riperdorimit, Grumbullimi i diferencuar | 0.2% | 0.0% | 0.0% | 0.0% | 0.0% | 0.0% | 0.0% | 0.0% |
| | D2 Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas legjislacionit | 100% | 22% | 90% | 90% | 80% | 80% | 60% | 50% |
| Qëndrueshmëria Financiare & Ekonomike | E1 Mbulimi i kostos | 83% | 12% | 56% | 25% | 12% | 17% | 38% | 33% |
| | E2 Shkalla e grumbullimit të tarifës | 111% | 33% | 103% | 55% | 55% | 47% | 58% | 50% |
| | E3 Transparenca e sistemit të faturimit | Mesatare | e ulet | e ulet | e ulet | e ulet | e ulet | e ulet | e ulet |
| Kost e shërbimit | Lek/ton | 4,733 | 20,995 | 19,047 | 10,880 | 27,677 | 26,115 | 9,975 | 11,980 |
| | Lek/banor/vit | 1,456 | 781 | 434 | 457 | 646 | 748 | 409 | 2,058 |

Figura15: Klasifikimi i rajoneve të Bashkisë Shkodër sipas kodeve të ngjyrave, bazuar në indikatorët e performancës së shërbimit

3.3.1 Punë në grup – Ushtrim për matjen e indikatorëve të performancës

Të gjithë pjesëmarrësit do të ndahen në katër grupe. Çdo grup do të ketë për detyrë të vlerësojë setin e indikatorëve të performancës për një nga aspektet e mëposhtme, për bashkitë që ata përfaqësojnë:

- (i) Cilësia e shërbimit;
- (ii) Qëndrueshmëria financiare;
- (iii) Qëndrueshmëria mjedisore;
- (iv) Aspekte institucionale.

Pas 20 minutash çdo grup duhet të prezantojë setin e indikatorëve të vlerësuar të klasifikuara sipas kodifikimit me ngjyra.

Pyetje të tjera për t'u adresuar:

- A janë NjQV të gatshme dhe a kanë të mundur të përdorin indikatorët e propozuar për të monitoruar aspektet e ndryshme të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve?
- A i zotërojnë ato të gjitha të dhënat e nevojshme për të bërë llogaritjet e indikatorëve të propozuar?
- Nëse jo, si mundën NjQV t'i gjenerojnë këto të dhëna?

- Si NjQV mund të ndërtojnë dhe të mirëmbajnë database-et e tyre të mbetjeve, në mënyrë që të kenë mundësi të raportojnë rregullisht në lidhje me këta indikatorë?

Për të zbatuar ushtrimin e mësipërm është e nevojshme që çdo pjesëmarrës të sjelli në ditën e trajnimit të plotësuar tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Variablat | Njësia | Vlerat | |
|-----|--|-----------|-----------------|-----------|
| | | | Viti 2014 | Viti 2015 |
| 1 | Numri i popullsisë | Persona | | |
| 2 | Sasia e prodhimit të mbetjeve | ton/vit | | |
| 3 | Sasia e mbetjeve të grumbulluara | ton/vit | | |
| 4 | Sasia e mbetjeve të grumbulluara veçmas (në mënyrë të diferencuar) | ton/vit | | |
| 5 | Sasia e mbetjeve të depozituara në venddepozitim ose Landfilld | ton/vit | | |
| 6 | Kosto totale operacionale e menaxhimit të mbetjeve | Lek / vit | | |
| 7 | Të ardhurat vjetore të planifikuara për t'u grumbulluar nga përfituesit e shërbimit: <ul style="list-style-type: none"> • Banorët • Bizneset • Institucionet | Lek / vit | Banorët = | |
| | | | Bizneset = | |
| | | | Institucionet = | |
| 8 | Të ardhurat vjetore të mbledhura nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve | Lek / vit | Banoret = | |
| | | | Bizneset = | |
| | | | Institucionet = | |
| 9 | Numri mesatar i ankesave të marra në një muaj nga përfituesit e shërbimit | Nr/muaj | | |
| 10 | Numri mesatar i ankesave të adresuara në një muaj | Nr/muaj | | |
| 11 | Në NjQV a keni një njësi/sector/departament të veçantë, i cili është përgjegjës për të planifikuar, financuar dhe ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve? | Po/jo | | |
| | A keni një organogram të detajuar për departamentin që merret me menaxhimin e mbetjeve? | | | |

| | | | |
|--|--|--|--|
| A janë të gjitha pozicionet e mbuluara me staf dhe a janë personat e punësuar të kualifikuar? | | | |
| A keni një plan lokal për menaxhimin e mbetjeve dhe a është ai duke u zbatuar? | | | |
| A mbani të dhëna për mbetjet në mënyrë të rregullt, keni krijuar ndonjë sistem të dhënash? | | | |
| A keni ndonjë sistem për të kontrolluar dhe supervizuar shërbimin e pastrimit dhe të menaxhimit të mbetjeve dhe a është duke u zbatuar ai? | | | |
| A keni ju evidencë të dokumentuara për procedurat e monitorimit të shërbimit, raporte proces-verbale etj.? | | | |
| A është i gjithë buxheti i menaxhimit të mbetjeve si një zë i veçantë i buxhetit për departamentin që merret me menaxhimin e mbetjeve? | | | |

3.4 Aktoret e përfshirë në sistemin e raportimit për menaxhimin e mbetjeve (sistemit të benchmark-ut)

Një sistem kombëtar benchmark-u ende nuk është hartuar plotësisht në vend. Megjithatë, në nivel kombëtar, disa të dhëna në lidhje me statistikat e mbetjeve raportohen si pjesë e raporteve të gjendjes së mjedisit ose raportohen direkt në Agjencinë Europiane të Mjedisit (EEA).

Megjithatë procesi i mbledhjes së të dhënave për menaxhimin e mbetjeve është i rregulluar me ligj. Përgjegjësia e bashkive në menaxhimin e mbetjeve fillimisht është e përcaktuar nga ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Më tej, për të forcuar kapacitetet monitoruese dhe për të bërë të mundur raportimin për mbetjet, një Vendim i ri i Kështillit të Ministrave "Mbi rregullat për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"¹ është miratuar. Ky vendim i Kështillit të Ministrave specifikon përgjegjësitë e bashkive dhe të institucioneve të tjera në nivel qendror (disa ministri të linjës) dhe agjencive shtetërore në mbledhjen e të dhënave për mbetjet, analizimin dhe raportimin e tyre. Në figurën e mëposhtme paraqitet sistemi institucional i monitorimit si dhe mënyra e rrjedhjes së raportimit për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve në të.

¹ DCM no. 687, dated 29.07.2015, Adoption of rules for maintenance, updating and publication of waste statistics




Figura16: Qarkullimi dhe raportimi i informacionit për mbetjet nga institucionet

Bashkitë janë të detyruara për të dhënë informacion vjetor për statistikat e mbetjeve të gjeneruara në territorin e tyre sipas formatit të mëposhtëm:

| Nr | Viti | Kodet sipas katalogut të mbetjeve |
|----|---|-----------------------------------|
| 1 | Nr. i banorëve | |
| 2 | Sasia e mbetjeve të prodhuara për banor (kg/vit) | |
| 3 | Sasia e prodhuar e mbetjeve urbane (kg or ton/vit) | 20 |
| 4 | Sasia e prodhuar e mbetjeve inerte (kg or ton/year) | 17 09 04 |
| 5 | Sasia e prodhuar e mbetjeve spitalore (kg or ton/year) | 18 01 10 |
| 6 | Sasia e prodhuar e mbetjeve plastike (kg or ton/year) | 17 02 03 ; 15 01 02 |
| 7 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të qelqit (kg or ton/year) | 15 01 07 |
| 8 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të metalit (kg or ton/year) | 17 04 07; 15 01 04 |
| 9 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të drurit (kg or ton/m ³) | 17 02 01; 15 01 03 |
| 10 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të letrës dhe kartonit (kg or ton/year) | 15 01 01; 03 03 08 |
| 11 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të baterive (kg or ton/year) | 16 06 01; 16 06 06 |
| 12 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të gomave (kg or ton/year) | 16 01 03; 400 400 00 |
| 13 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të vajrave të përdorur (kg or ton/year) | 12 01 06; 12 01 10 |
| 14 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të kafshëve (kg or ton/year) | 02 01 02 |
| 15 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të tekstileve (kg or ton/year) | 04; 15 09 04 |
| 16 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të WEE (kg or ton/year) | 16 02; 20 01 36 |
| 17 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të depozituara në landfill (ton/vit) | |
| 18 | Sasia e prodhuar e mbetjeve të djegura në incenerator (ton/vit) | |

Figura 17: Statistikat e mbetjeve që duhen raportuar nga NjQV

Çdo NjQV duhet të raportojë te këshilli i qarkut, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKE) dhe te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës jo më vonë se 31 Janari i çdo viti. Në nivel qendror, gjithashtu, ministrinë e linjës si: Ministria e Buqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, në përputhje me VKM nr. 1189, dt. 18/11/2009 "Mbi rregullat dhe procedurat për hartimin dhe implementimin e një programi kombëtar për monitorimin e mjedisit" duhet të raportojnë jo më vonë se 10 shkurti tek AKE. AKE mbledh, mirëmban dhe përditëson statistikat mbi mbetjet dhe ia

raporton ato Ministrisë së Mjedisit brenda datës 28 Shkurt të çdo viti. Përfundimisht është Ministria e Mjedisit ajo që publikon në version elektronik raportin 3-vjeçar mbi statistikat e mbetjeve, i cili duhet të jetë i vlefshëm për publikun dhe i prezantuar në web sit-in e ministrisë.

3.4.1 Ushtrim / Diskutim – Statistikat e mbetjeve të gjeneruara në nivel lokal

Pikat që do të diskutohen me të gjithë pjesëmarrësit:

- (i) Si bashkitë mund të ndërtojnë database-et e tyre për menaxhimin e mbetjeve dhe si mund të gjenerojnë të gjitha të dhënat që do të duhet të raportohen çdo vit, sipas VKM nr. 687, datë 29.07.2015?
- (ii) Cilët janë aktorët që mund të ndihmojnë në këtë proces dhe në cilin nivel mund të maten ose të gjenerohen të dhënat e kërkuara?
- (iii) Çfarë mjetesh, metodash apo formatesh, sistem raportimi duhet të përdorin NjQV-të dhe kush do të jetë roli specifik dhe kontributi i çdo aktori të përfshirë në këtë proces?

Shtojcë- Shembull– Ilogaritja e përballueshmërisë

1. TESTIMI ME SHIFRA REALE

Bashkia Lezhë
Viti 2015

Sipas vëzhgimit dldp (viti 2015) për Bashkinë e Lezhës (duke marrë në konsideratë bashkinë e re) e cila përbëhet nga 10 njësi administrative përkatësisht: Lezhë, Shëngjin, Balldre, Kallmet, Zejmen, Shënkoll, Dajç, Blinisht, Kolsh dhe Ungrej për buxhetin për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve janë identifikuar shifrat e mëposhtme (në total për bashkinë e re):

- Buxheti total i bashkisë (si zakonisht duke mbledhur të gjitha buxhetet e 2015) = **647,301,617 ALL**
- Buxheti total i bashkisë lidhur me shërbimet për menaxhimin e mbetjeve të ngurta = **29,240,587 ALL**
- Kosto totale për menaxhimin e mbetjeve të ngurta = **50,780,787 ALL**
- Hendeku financiar në mes të buxhetit të vet të ndarë dhe të kontratave të dhëna= **36,680,000 ALL** in **përqindje 50 %**
- Përqindja e koston për të ofruar shërbimin = **8%**
- Kapaciteti i rikuperimit të kostove (tarifat e grumbulluara) në përqindje = **36%**
- Tarifa e paguar ekv.banorë./vit = **471 ALL (maks. 816 ALL, min. 91 ALL).**

Matjet e mësipërme konsiderojnë një shërbim që nuk ofrohet për të gjithë banorët në njësitë përkatëse (vetëm 63% e marrin atë). Për më tepër, shërbimi nuk është ofruar siç kërkohet nga legjislacioni sektorial, duke marrë parasysh të paktën 3 kazanët për ndarjen e mbetjeve.

2. TESTIMI ME MODELIM

Pajtueshmëria me dispozitat normale të shërbimit

Bashkia Lezhë

Përlllogaritje

Ky testim merr në konsideratë detyrimet e mëposhtme:

1. Shërbimi i është ofruar të gjithë qytetarëve;
2. Mbetjet janë dërguar në landfill;
3. Bashkia e mbulon tërësisht shërbimin;
4. Qytetarët paguajnë si zakonisht tarifën;
5. Kosto e landfillit vazhdon të qëndrojë shumë e ulët (600 ALL/ton).

Të dhënat për testimin janë kryer nga mjetet për modelimin e kostos zhvilluar nga dldp. Të dhënat për popullsinë dhe gjenerimin e mbetjeve janë mbledhur nga vëzhgimi i përmendur më lart për çdo njësi. Modelimi është kryer duke marrë parasysh që çdo njësi merr shërbimin si një zonë e shërbimit.

Bazuar në këtë, janë gjeneruar shifrat e mëposhtme:

- Buxheti total i bashkisë (si zakonisht duke mbledhur të gjitha buxhetet e 2015)= **647,301,617 ALL**
- Kosto totale për ofrimin e shërbimit (llogaritur) = **95,801,225 ALL**
- Përqindja e kostos për ofrimin e shërbimit = **15%**
- Kapaciteti i mbulimit të kostos në përqindje (duke marrë në konsideratë pagimin e tarifës nga të gjithë klientët për 2015) = **23%**
- Tarifa për t'u paguar ekv. banorë/vit = **936 ALL** (*max 1400 ALL, min 605 ALL*).
- Hendeku tarifës eqv. banorë/vit = **466 ALL**

Llogaritjet tregojnë një barrë të mëtejshme të kapaciteteve buxhetore lokale për të mbuluar shërbimin. Në mënyrë që të zgjedhim sistemin i cili siguron të gjithë qytetarët e bashkisë dhe të mbetet me kapacitetet financiare të Testit 1 (biznesi si zakonisht), buxheti i përgjithshëm i bashkisë duhet të rritet me rreth 45 milion lekë, rreth 50%.

3. TESTIMI ME VLERAT E PROJEKTUARA

Përputhje të plotë me legjislacionin

Bashkia Lezhë

Përlllogaritje

Ky testim merr në konsideratë detyrimet e mëposhtme:

1. Shërbimi i është ofruar të gjithë qytetarëve;
2. Mbetjet janë dërguar në landfill (tarifa paguhet edhe për bizneset);
3. Bashkia e mbulon tërësisht shërbimin;
4. Qytetarët paguajnë si zakonisht tarifën;
5. Shërbimi mundësohet në bazë të kërkesave të ligjit:
 - Sistemi i 3 koshave
 - Rikuperimi i mbetjeve (kosha special vetëm për letrën)

Të dhënat për testimin janë kryer nga mjetet për modelimin e kostos zhvilluar nga dldp. Të dhënat për popullsinë dhe gjenerimin e mbetjeve janë mbledhur nga vëzhgimi i përmendur më lart për çdo njësi. Modelimi është kryer duke marrë parasysh që çdo njësi merr shërbimin si një zonë e shërbimit (optimizimi mund të arrihet këtu). Prandaj një numër shtesë koshash dhe kamionësh është e nevojshme.

Numri i koshave në total është i ndarë në 30% për mbetje të thatë. Një numër shtesë koshash për rikuperimin e letrës është shtuar në sistem me një përqindje në total 5%.

- Buxheti total i bashkisë (si zakonisht duke mbledhur të gjitha buxhetet e 2015)= **647,301,617 ALL**
- Kosto totale për ofrimin e shërbimit (llogaritur) = ~**105,000,000 ALL**
- Përqindja e kostos për ofrimin e shërbimit = **17%**
- Përqindja e kostos për ofrimin e shërbimit (duke marrë në konsideratë pagesën e tarifës nga të gjithë klientët për 2015) = **20%**
- Tarifa për t'u paguar ekv. banorë/vit = **1064 ALL** (*max 1723 ALL, min 778 ALL*).
- Hendeku i tarifës eqv. banorë/vit= **593 ALL**

